



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**INSTITUCIONI I PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER**



**RAPORT**

**PËR VEPRIMTARINË E KRYER NGA INSTITUCIONI GJATË VITIT 2018**

## **RAPORT**

### **Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2018**

Qellimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2018, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kerkesat e Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*”

**Hartuar nga:** Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

**Adresa:** Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel /faks. 00355 2224 2705, e-mail: [Prefekti.Shkoder@mb.gov.al](mailto:Prefekti.Shkoder@mb.gov.al)

Shkoder, Janar 2019

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (*Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike*), në nivel qarku

## Përmbajtja

I.	Hyrje.....	5
II.	Përmbledhje .....	6
III.	Baza Ligjore .....	10
IV.	Realizimi i detyrave dhe prioriteteve, në lidhje me programin e qeverisë.....	12
IV.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave.....	12
IV.2.	Realizimi i Investimeve.....	13
V.	Marrëdhëniet e Prefektit me Administratën e shtetit (Adm. Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor-Degët Territoriale).....	16
V.1.	Institucionet në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre.....	17
V.2.	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim.....	29
V.3.	Problemet e konstatuar nga analizat mujore të punës së institucioneve qendrore në nivel vendor.....	32
V.4.	Grupet e punës ndërinsticionale (task-forcat).....	32
V.4.1.	Task Forca Vendore antikanabis.....	33
V.4.2.	Zbati i i masave, lidhur me çështjet e luftës kundër trafikimit të personave.....	36
V.6.	Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat.....	38
VI.	Marrëdhëniet e Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).....	44
VI.1.	Kryerja e funksioneve të transferuara njësite të vetëqeverisjes vendore.....	45
VI.2.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.....	50
VI.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor.....	52
VII.	Funksionet e deleguara, kryerja e veprimtarisë nga institucionet të cilave u janë deleguar funksionet nga institucionet qendrore.....	53
VII.1.	Verifikimi i titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore .....	53
VII.2.	Shërbimet sociale .....	54
VII.3.	Zhvillimi i territorit.....	55
VII.4.	Zhvillimi i turizmit.....	56
VII.5.	Shërbimi i Gjëndjes Civile.....	60
VIII.	Organizimi dhe veprimtaria e administratës së Prefektit.....	61
VIII.1.	Organizimi.....	61
VIII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	63
VIII.3.	Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	63
VIII.4.	Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	65
VIII.5.	Veprimtaria e N/Prefektit.....	66
IX.	Veprimtari të tjera të Prefektit.....	66
X.	Objektivat për vitin 2019.....	67

## **RAPORT**

### **Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2018**

#### **I. HYRJE**

Raporti, i cili paraqet veprimtarinë dhe performancën e Institucionit është në pajtueshmëri me kërkesën për rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike

Raporti pasqyron realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës. Në raportin pasqyrohet programimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut dhe Bashkitë, brenda territorit të qarkut), si dhe nga institucionet qendrore në nivel vendor; Treguesit e punës; marrëdhëniet e Prefektit me administratën qendrore dhe rajonale, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë); Bashkëpunimi dhe koordinimi punës për realizimin e detyrave të ngarkuara; Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore; Problemet e rendit e sigurisë publike; Veprimtaria e kryer në parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Veprimtaria në çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në vazhdim; Kryerja e funksioneve të transferuara nga Institucionet qendrore njësive të vetëqeverisjes vendore (Shërbimi Mbrojtjes nga Zjarri, administrimi i pyjeve, sistemi i ujitjes dhe kullimit, menaxhimi i rrjetit të rrugëve rurale, sistemi i arsimit parashkollor). Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të turizmit; Përballimit të situatave të emergjencave civile; Kryerjes së funksioneve të deleguara; Vlerësimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore. Po kështu në raport trajtohen problemet e ndjekjes dhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve; Urdhrat e nxjerra nga ana e Prefektit dhe zbatimi i tyre; Problemet e konstatuara gjatë analizave vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, etj.

Për hartimin e raportit përveç të dhënave të institucionit dhe të dhënave monitoruese, janë përdorur edhe të dhënat e institucioneve qendrore në nivel qarku, si dhe të dhënat e njësive të vetëqeverisjes vendore

## II. PËRMBLEDHJE

- Gjatë vitit, si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës, është përmirësuar performanca e institucioneve qendrore në nivel vendor si dhe e njësive të vetëqeverisjes vendore. Me transferimin e funksioneve, i cili është shoqëruar edhe burimet e nevojshme financiare (Fondet e buxhetit, në formën e transfertës specifike, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, gjatë vitit janë rritur në masën 16.5 %, krahasuar me vitin e kaluar), tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, është mundur që shërbimet të jenë më afër qytetarit

- Arritjet në realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës, janë rezultat i rritjes së nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administratës publike.

- *Të ardhurat e realizuara në nivel qarku*

- Tatime, taksa nacionale dhe kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore, të arkëtuara nepermjet Drejtorisë Rajonale të Tatimeve janë realizuar me një vlerë prej 5,554,404 mijë lekë, ose 101.5 % e të ardhurave të programuara, me një rritje prej 531,836 mijë lekë nga vitit i kaluar. Realizimi i të ardhurave është rezultat i bashkëpunimit të të gjitha institucioneve në goditjen e informalitetit. Për shkeljet e konstatuara gjatë 2101 inspektimeve dhe verifikimeve të ushtruara në terren nga ana e Drejtorisë Hetimit Tatimor në subjekte, janë: Referuar në prokurori 33 subjekte, Marrë masa administrative, penaltete në 655 raste

- Të ardhura doganore, nga Dega e Doganës, janë realizuar me vlerë 3,260,906 mijë lekë, ose 93 % e të ardhurave të programuara, me një rënie nga nga vitit i kaluar prej 788,094 mijë lekë

- Të ardhura të njësive të vetëqeverisjes vendore (Këshilli i qarkut dhe bashkitë) janë realizuar me një vlerë prej 951,108 mijë lekë, ose 93.6 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 64,909 mijë lekë (peshën më të madhe me 60,027 mijë lekë, ose 92.5 % të mosrealizimit e zë bashkia Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës), me një rritje nga të ardhura e realizuara në vitit e kaluar, prej 169,924, ose 21.7 % mijë lekë,

Në realizimin e të ardhurave, ndikim të rëndësishëm ka patur rritja e të ardhurave nga turizmi, duke reflektuar zhvillimin që ka marrë ky sektor i ekonomisë, në saje të masave, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqatat dhe subjektet që zhvillojnë aktivitet në fushën e turizmit, si dhe investimeve të kryera në infrastrukturë, në shërbim të këtij sektori, në zbatim të programit të qeverisë. Me gjithë progresin e bërë (Krahasuar me vitin e kaluar, është rritur numri i shtetasve dhe mjeteve të përpunuara në pikat doganore; Numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese; Numri i subjekteve private të regjistruara, të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi: Xhiroja e subjekteve deklaruese, gjatë vitit janë hasur edhe

probleme (Gjëndja e rrugëve; Trafiku i rënduar i mjeteve gjatë sezonit; Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike; Mos zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së plazhit”; Mos zbatimi i kushteve për krijimin e sigurisë në pazh; Mungesa e trajnimeve dhe Udhërrefyesve turistik; etj), të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e turizmit

- *Investimet*

- Janë kryer investime në njësitë e vetëqeverisjes vendore (me fondet e buxhetit të shtetit dhe fondet e veta) me një vlerë prej 4,562,159 mijë lekë (Këshilli i qarkut 56,601 mijë lekë, në territorin e bashkisë Shkodër 2,483,436 mijë lekë, të bashkisë Malësi e Madhe 282,294 mijë lekë, të bashkisë Vau i Dejës 512,843 mijë lekë, të bashkisë Pukë 1,089,866 mijë lekë dhe të bashkisë Fushë Arrëz 124,100 mijë lekë). Në investimet e kryera në territorin e qarkut, sipas njësisë të vetëqeverisjes vendore përveç investimeve me fondet nga të ardhurat e veta përfshihen edhe investimet e kryera me fondet e buxhetit, nga institucionet qendrore (487,998 mijë lekë) dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (3,251,447 mijë lekë) për ndërtim e rikonstruksion shkolla, sistemim asfaltim rrugë, rikualifikim urban, përmirësim i rrjetit ujitës, ndërtim banesa sociale, etj.

- Janë kryer investime në sektorin e energjisë me fondet nga të ardhurat e Shoqërive Aksionare me vlerë 1,393,642 mijë lekë (OShEE Sh.A 530,066 mijë lekë, OST Sh.A 2,041 mijë lekë dhe KESh Sh.A 861,535 mijë lekë), investime të cilat, falë edhe masave të marra dhe bashkëpunimit me institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me strukturat e policisë vendore, kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike (furnizim pa ndërprerje të konsumatorëve), si dhe në zvogëlimin e nivelit të humbjeve

- Janë në proces realizimi investime me vlerë 573,528 mijë lekë në 3 bashkitë e qarkut; Në bashkinë Malësi e Madhe 175,773 mijë lekë, nga të cilat nga bashkia 99,000 mijë lekë, në 7 objekte, (“Rikonstruksion, sistemim e asfaltim në 6 rrugë” 54,745 mijë lekë dhe “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Koplik” me vlerë 44,255 mijë lekë), si dhe nga FShZh me vlerë 76,773 mijë lekë për objektin “Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit Tamarë (Faza II-të dhe mbrojtje lumore dhe asfaltim rrugës së doganës Vermosh (0.7 km)”

Në bashkinë Shkodër, investim që po kryhet nga FShZh, me fondet e buxhetit të shtetit në objektin “Rikonstruksion i sheshit Shirokës” me vlerë 309,008 mijë lekë

Në bashkinë Fushë Arrëz, me fondet e buxhetit, me vlerë 88,747 mijë lekë për rikonstruksionin e 2 shkollave (“Rikonstruksion i shkollës Iballë” dhe Shkolla e mesme “70 vjetori i Pavarsisë”)

- Janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor; Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe; Nuk ka nxënës të cilët kanë braktisë shkollën, për shkak të gjakmarrjes; Gjatë vitit nuk ka mesues pa arsimin përkatës dhe jashtë profilit. Për arsye të ngarkesës dhe rikonstruksionit të godinës së

shkollës, procesi mësimor në 5 shkolla zhvillohet me 2 turne (Në qytetin Shkodër në 4 shkolla dhe në bashkinë Fushë Arrëz në 1 shkollë), si dhe për arsye rikonstruksioni mësimi për shkollën Iballë zhvillohet në ambientet e Nj.A.

- Është rritur numri i të punësuarve (numri i personave, për të cilët është llogaritur dhe derdhur kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore) gjatë vitit me 257 vetë, krahasuar me vitin e kaluar (31,710 vetë nga 31,453 vetë që ka qenë në vitin e kaluara), rritje e cila ka ardhur kryesisht nga punësimi në sektorin privat, duke bërë që të ketë rënie të numrit të punëkërkuarve të papunë të regjistruar. Numri i punëkërkuarve të papunë të regjistruar në fund të vitit ka qenë 5329 persona nga 7055 persona, që ishte në fund të vitit të kaluar, ose 1726 persona më pak.

Gjatë vitit është intensifikuar goditja ndaj informalitetit, çka shihet edhe në treguesit e rritjes së të ardhurave, të subjekteve private të regjistruara dhe në numrin e të punësuarve.

Në fund të vitit mundësitë e punësimit janë për 1532 persona, vende të lira punë në përpunin produkte ushqimore, përpunim druri, tregëti e shërbime, FA, etj.

- Me fondet e buxhetit janë trajtuar me ndihmë ekonomike 4705 familje dhe pagesë paaftësie 11641 persona (Persona me aftësi ndryshe e kujdestar të tyre 7088 persona dhe invalid të punës 4553 perona)

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nepermjet inspektimeve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe verifikimeve në familje, për administrimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe pagesës paaftësisë, janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike 42 familje dhe 31 persona, të cilat e përfitonin në shkelje të ligjit.

- Situatat e emergjencave të krijuara gjatë gjithë vitit në territorin e qarkut (situatat dimerore të krijuara nga reshjet e shiut Shkurt-Mars, të cilat kanë shkatërruar përmbajtje dhe ato verore Gusht-Tetor nga rena e zjarreve) si rezultat i bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat e policisë së shtetit, autoritetin rajonal të rrugëve, shërbimin pyjor, strukturat e MM (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile), me mbështetjen e vazhdueshme të MB dhe të strukturave të tjera shtetërore, janë përballuar në mënyrën më të mirë të mundshme (Gjatë stinës së verës janë shfaqur 36 vatra zjarri, të cilat kanë përshkuar një sip. prej 1735 Ha pyje dhe kullota, si dhe 114 Ha ullishte, duke djegur 11.8 Ha pyje dhe 17314 rrënjë ullinj)

- Kriminaliteti gjatë vitit, krahasuar me vitin 2017, është ulur në masën 1 %, ose me 14 vepra penale më pak (Nga 2306 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2017 në vitin 2018 janë evidentuar 2292). Ndërsa shkalla e zbulueshmërisë është rritur 2 % krahasuar me vitin e kaluar (nga 87.4 % në 89.4 %)

- Krahasuar me vitin e kaluar, si rezultat i sensibilizimit, ndërgjegjësimit, bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në Task Forcën Vendore dhe me Njësitë e vetëqeverisjes Vendore, për realizimin e detyrave



të përcaktuara në planet operationale të tyre (në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020), është zvogëluar numri i parcelave 31, i rasteve 14 dhe numri i bimëve të kanabisit të kultivuara 12034 rrënjë. Po kështu është rritur edhe forca goditëse, çka shihet në rritjen masës së zbulueshmërisë së autorëve me 11.4 % krahasuar me vitin e kaluar

- **Trafikimi i personave**, ka patur rënie të treguesve të evidentimit, që ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit të Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit.

- Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit, ushtrimit te pergjegjesive dhe veprimtarise jane nxjerre 70 Urdhra; Jane zhvilluar mbi 60 takime si me grupin keshillues pranë Prefektit, ashtu edhe me drejtues te institucioneve qendrore ne nivel vendor, te njesive te veteqeverisjes vendore, etj., per zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në planin e veprimit antikanabis, për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, problemet e emergjencave civile, menaxhimin e mbetjeve, mbarevajtjen e sezonit turistik, titujt e pronesise mbi token bujqesore, ligjshmerine e akteve te nxjerra nga njesite e veteqeverisjes vendore, etj.; Jane shqyrtuar dhe vleresuar, duke u kthyer pergjigje, 103 kerkesa dhe ankesa të ndryshme te qytetarve, subjekteve publike e private

- Institucioni i Prefektit gjatë vitit ka qenë pjesë përbërse e grupit ndërinstytucional (Task Forcës), të ngritur, lidhur me: Kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Monitorimin e veprimtarisë së therjes së kafshëve dhe transportit e tregtimit të mishit; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2018”; Monitorimin dhe kontrollin e masave, për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe; Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore; Identifikimin e Nevojave për Reabilitimin e Shtretërve të Lumenjëve; Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private

- Nga 567 akte të depozituara, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në Institucionin e Prefektit, për verifikim ligjshmërie, Prefekti ka vlerësuar se janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore 474 akte; Është shprehur negativisht, për shkak se kanë qenë jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, për 93 akte, nga të cilat janë rishqyrtuar 22 prej tyre dhe për rastet e tjera nuk është lejuar procedimi i mëtejshëm. Gjatë vitit është bërë verifikimi në vend i akteve të nxjerra nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Ka vazhduar asistimi me ndihmë juridike në mënyrë qoftë verbalisht apo edhe me dhënie

Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në interpretimin e ligjit dhe zbatimin e drejtë të tij

- Nga ana e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore janë ushtruar kontrollet direkte për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të AMTP – ve të plotësuar në tokat bujqësore të ish NB të qarkut. Për shqyrtimet administrativ, mbi bazën e dokumentacionit të kërkuar, si dhe verifikimeve, Komisioni ka nxjerrë 81 Vendime, për shfuqizim të plotë apo të pjesshëm të AMTP, apo për pezullim

### III. BAZA LIGJORE

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligji Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
- Ligji Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligji Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligji nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligji Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”
- Ligji Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji nr. 9131, date 08.09.2003 “Per rregullat e etikes se administrates publike”
- Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me ndryshime
- Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj Nr.9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"
- Ligji nr. 9154, date 06.11.2003 “Per arkivat”, me ndryshime
- Ligji nr 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligji Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Ligji Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshime
- Ligji Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime
- Ligji nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh”, me ndryshime
- Ligji nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, me ndryshime
- Ligji nr 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik”, me ndryshime
- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me

ndryshime

- Ligji Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime
- Ligji Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “Për inspektimin financiar publik”
- Ligji Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me ndryshime
- Ligji Nr. 9482, datë 06.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, me ndryshime
- Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", me ndryshime
- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”
- Ligji 8756 date 26.03.2001 “Për Emegjencat Civile”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10129 date 11.05.2009 “Per gjendjen civile”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8951 datë 10.10.2002 “Për numrin personal të shtetasve”, me ndryshime
- Ligji Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime
- Ligji Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime
- Ligji nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”
- Ligji Nr. 9948 date 07.07.2008 “Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore”
- Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit

#### IV. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË

##### IV.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave

##### IV.1.a. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Janë realizuar të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore me një vlerë prej 951,108 mijë lekë, ose 93.6 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 64,909 mijë lekë, ku 92.5 % e mosrealizimit i përket bashkisë Malësi e Madhe dhe Vau i Dejës (Bashkia Malësi e Madhe me një mosrealizim prej 31,735 mijë lekë, ose 48.9 % dhe Vau i Dejës me 28,292 mijë lekë, ose 43.6 %).

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2018 dhe 2017, paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat gjithësej				
		Viti 2018			Viti 2017	
		Program	Fakt	%	Fakt	%
1	Keshilli i Qarkut	14,230	10,054	70.7	681	24.3
2	Bashkia M. Madhe	98,375	66,640	67.7	44,151	42.9
6	Bashkia Shkoder	678,761	701,593	103.4	612,033	98.4
5	Bashkia Vau i Dejes	154,651	126,359	81.9	82,515	53.9
3	Bashkia Puke	44,000	25,510	58.0	20,812	55.5
4	Bashkia Fushe-Arrez	26,000	20,952	80.6	20,992	100.0
	<b>Totali</b>	<b>1,016,017</b>	<b>951,108</b>	<b>93.6</b>	<b>781,184</b>	<b>83.2</b>

Gjatë vitit 2018 realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar me një vlerë prej 169,924 mijë lekë, ose 21.7 %. Megjithë rritjen e të ardhurave të realizuara krahasuar me vitin e kaluar, mosrealizimi i të ardhurave të programuara flet për një punë të pamjaftueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore në shfrytëzimin e burimeve financiare, me ndikim në kryerjen e shërbimeve dhe investimeve, si dhe zhvillimit të njësive të vetëqeverisjes vendore

##### IV.1.b. Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 5,554,404 mijë lekë, ose 101,5 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 84,403 mijë lekë (tejkalim i cili ka ardhur nga të ardhurat tatimore, pasi të ardhurat nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore ka një mosrealizim në shumën 35,173 mijë lekë) dhe me një rritje nga viti i kaluar prej 531,836 mijë lekë dhe viti 2016 prej 704,880 mijë lekë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas zërave për vitin 2018 dhe 2017 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2018			2017	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Tatim mbi vlerën e shtuar	340,002	402,822	118.5	340,873	116
2	Ttım-fitimi	477,999	557,396	116.6	406,961	112
3	Tatim mbi të ardh. personale	810,000	776,895	95.5	693,260	104
4	Taksa nacionale	42,000	38,342		43,528	104
5	Gjoha		14,032		8,234	
	<b>Totali Tatime</b>	<b>1,670,</b>	<b>1,789,577</b>	<b>107.2</b>	<b>1,492,856</b>	<b>109</b>
5	KONT.SIGUR.	3,800,000	3,764,827	99.1	3,529,712	101
	<b>Gjithsej</b>	<b>5,470,001</b>	<b>5,554,404</b>	<b>101.5</b>	<b>5,022,568</b>	<b>103</b>

#### IV.1.c. Të ardhura Doganore

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 3,260,906 mijë lekë, 93 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 234,059 mijë lekë, si dhe me një rënie nga viti i kaluar prej 788,094 mijë lekë. Ndërsa të ardhurat dytësore nga 22,328 mijë lekë janë realizuar 18,916 mijë lekë, ose 84.8 %, me një mosrealizim prej 3,412 mijë lekë

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2018 dhe 2017 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Emertimi	Viti 2018			2017	
		Plan	Fakt	%	Fakt	%
1	Të ardhura	3,494,965	3,260,906	93	4,049,000	102

Nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 76,890 mijë lekë, me një rritje nga vitit i kaluar prej 17,707 mijë lekë ( për vitin 2017 me vlerë 59,183 mijë lekë) mijë lekë. Ndërsa nga ALUIZNI janë realizuar të të ardhura me vlerë 27,045 mijë lekë.

#### IV.2. Realizimi i Investimeve

##### IV.2.a. Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Janë kryer shpenzime për investime gjatë vitit 2018 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (me të ardhurat e veta dhe me fondet e buxhetit) me vlerë 822,714 mijë lekë nga 1,535,422 mijë lekë, ose 53.6 % e shpenzimeve të programuara, sipas njësive

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Plan	Fakt
1	Këshilli i Qarkut	80,722	56,601
2	Bashkia Shkodër	683,767	277,312
3	Bashkia Malësi e Madhe	272,818	264,326
4	Bashkia Vau i Dejës	350,262	80,326
5	Bashkia Pukë	23,753	20,049
6	Bashkia Fushë Arëz	124,100	124,100
	<b>Shuma</b>	<b>1,535,422</b>	<b>822,714</b>

#### IV.2.b. Investime me fondet e qeverisë nga FShZh

Në 4 bashkitë e qarkut, investimet të cilat po kryhen nepermjet FShZh (investime, të filluara gjatë vitit 2017-2018 dhe me afat përfundimi gjatë vitit 2018-2019) me vlerë totale 3,959,993 mijë lekë, sipas objekteve

Nr.	Bashkia	Emertimi i objektit	Kontrata e sipërmarrjes			Ecuria e zbatimit	
			Vlera (000/lekë)	Fillimi	Përfundim i	Vlera (000/lekë)	%
1	Shkodër	Rikonstruksion i rruges Shkoder Velipoje segmenti Harku i Berdices - Baks (Lot I-rë, II-të dhe III-të)	2,297,167	29.06.2017	31.03.2019	2,002,670	87.2
2	Vau i Dejes	Nërtim i unazes qyteti Vau Dejes	178,960	05.06.2017	04.04.2018	178,960	100
3	Pukë	Rikualifikim urban dhe mjedisor të disa nënprojekteve në qendër të qytetit Pukë dhe liqeni i vogël	173,522	13.06.2017	13.10.2018	164,865	100
4	Pukë	Rikonstruksion (Rehabilitim dhe veshje me asfalt) i rrugës F.Arëz (K/Hadrojit)-Reps (Rotonda)	924,503	05.05.2017	05.11.2018	904,952	100
5	Shkoder	Rikonstruksion i sheshit të Shirokës	309,008	05.10.2018	05.07.2019	61,000	20
6	Malësi e Madhe	Rikonstruksioni i fasadave dhe Sheshit Tamare (faza II-të) dhe Mbrojtje lumore dhe asfaltimi i rruges se Doganes Vermosh (0,7 km)	76,773	05.12.2018	05.10.2019	0	1

#### IV.2.c. Investime me fondet e buxheti, nga institucionet qendrore

Gjatë vitit janë kryer investime me fondet e buxheti në njësitë e vetëqeverisjes

vendore me vlerë 487,998 mijë lekë

- Në bashkinë Vau i Dejës
  - Ndërtim i lëndfill Bushat (Faza II-të) 126,005 mijë lekë;
  - Rikonstruksion i rrjetit të ujësjellësi fshati Mëlgushë (Faza II-të) 11,456 mijë lekë;
  - Rikonstruksion i shkollës mesme të bashkua Hajmel 25,199 mijë lekë;
  - Rikualifikim i qendrës së qytetit Vau i Dejës (Faza II-të) 5,605 mijë lekë;
  - Rehabilitim fasada në ndërtesat e bashkisë Vau Dejës 21,295 mijë lekë;
  - Rikualifikim i rrugës Hajmel-Dheu i Lehtë-Pistull (Loti II-të) 63,997 mijë lekë)
- Në bashkinë Shkodër
  - Rikonstruksion e punime stacioni i pompave Trush 10,324 mijë lekë;
  - Rikualifikim urban i rrugicave në qendër të qytetit Shkodër 12,326 mijë lekë;
  - Rikonstruksion i bllokut të pallateve Xhabije 19,407 mijë lekë;
  - Përmirësim i kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian 7,933 mijë lekë;
  - Për arsimin e lartë (Rikonstruksion salla konferencave Fakulteti Gjuhëve të huaja Universiteti Shkoder e blerje pajisje) 11,163 mijë lekë;
  - Për strukturat e policisë së shtetit (Ndërtim dhe rikonstruksion i godinës së DVP) 142,301 mijë lekë
- Në bashkinë Malësi e Madhe
  - Ndërtim PKK Hani Hotit 17,968 mijë lekë

#### **IV.2.d. Investime në sektorin e ujit të pijshëm**

Për përmirësimin e nivelit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm me fondet nga të ardhurat e Sh.A Ujësjellës dhe të bashkive, janë kryer shpenzime për investime me vlerë 28,776 mijë lekë (Në Sh.A “Ujësjellës Shkodër” 5,604 mijë lekë; M.Madhe 5,669 mijë lekë, Vau Dejës 2,978 mijë lekë dhe Fushë Arrëz 4,525 mijë lekë)

#### **IV.2.e. Investime për zhvillimin bujqësor (sistemi i ujitjes dhe kullimit)**

Janë kryer investime, me fondet e buxhetit, për përmirësimin e sistemit të ujitjes me vlerë 198,858 mijë lekë (Kanali i ujitjes Rragam; Kanali i Ujitjes Mjedë-Koterr; Kanali i Ujitjes Mjedë-Kosmaç; Mbrojtje nga gërryerjet e lumit “Buna” në Nj.A Oblikë)

#### **IV.2.f. Investime në sektorin e energjisë elektrike**

Janë kryer investime në sektorin e energjisë elektrike me vlerë 1,393,642 mijë lekë

OShEE Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, 530,066 mijë lekë (Ndërtim rrjeti TU 0.4 KV në Rajonin Shkodër; Ndërtim i linjës TM kabllore, Spitali Rajonal Shkoder Fidri-14 N; Rikonstruksion i rrjetit TM/TU Theth F-Hec Ndërlisë; Ndërtim Fidrit të Ri N/S 35/6 kv Velipojë dhe ndërtim i disa kabinave; etj)

OST Sh.A, me fonde nga të ardhurat e veta, 2,041 mijë lekë

KESh Sh.A, me fondet nga të ardhurat e veta, 861,535 mijë lekë ("Furnizim-vendosje e sistemevetë reja AVR për AG1 dhe AG2 dhe upgrade i firmware-it të 5 seteve të monitorimit on-line BMT të transformatorëve të fuqisë V.Dejës"; "Punime mbrojtëse tek krahu i majtë i kanalit të daljes nga ndërtesa e centralit deri tek ura si dhe veshja me beton e faqeve anësore të kanalit në HEC Koman"; "Furnizim vendosje e sistemit të monitorimit të shkarkimeve pjesore tek gjeneratorët G2 dhe G4, PDGM dhe instalimi i sistemit të monitorimit on-line të shkark. pjesore në gjeneratorët e Hec Vau Dejës"; "Furnizim vendosje 2 grupe baterish akumulatore (220 VDC/300 Ah) dhe 2 grupe baterish akumulatore (48VDC/450Ah) në Hec Vau Dejës"; "Blerje kompresori i presionit të lartë i pajisjeve për frymëmarrje të polumbarëve dhe riparimi i setit DGA të transformatorit të fuqisë Nr. 5 në HEC Vau i Dejës"; etj.)

#### **IV.2.h. Investimet në proces realizimi**

Në bashkinë Malësi e Madhe me vlerë 175,773 mijë lekë, nga të cilat nga bashkia 99,000 mijë lekë, në 7 objekte, ("Rikonstruksion, sistemim e asfaltim rrugë në rrugë rurale Koplík i sipërm, Kaldrun, Ducaj, Gruemirë Jubicë" 54,745 mijë lekë dhe "Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare A.Bajraktari" me vlerë 44,255 mijë lekë), si dhe nga FShZh me vlerë 76,773 mijë lekë për objektin "Rikonstruksion i fasadave dhe sheshit Tamarë (Faza II-të dhe mbrojtje lumore dhe asfaltim rrugës së doganës Vermosh (0.7 km))"

Në bashkinë Shkodër, investim që po kryhet nga FShZh, me fondet e buxhetit të shtetit në objektin "Rikonstruksion i sheshit Shirokës" me vlerë 309,008 mijë lekë

Në bashkinë Fushë Arrëz, me fondet e buxhetit, me vlerë 88,747 mijë lekë për rikonstruksionin e 2 shkollave ("Rikonstruksion i shkollës Iballë" dhe Shkolla e mesme "70 vjetori i Pavarsisë")

### **V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor)**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkoder në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me njësitë e veteverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e Institucioneve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionet në nivel Qarku.

Gjatë vitit rëndësi i është kushtuar zbatimit të VKM-së nr.253, dt 6.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi



*për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave” dhe VKM nr.222, dt 6.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, proces për të cilin janë organizuar takime me drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkive dhe Njësive Administrative), përfaqësues të Komisionit Qeveristar të Tokës, të Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme.*

Prefekti ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore, Degët Territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe veprimtaritë e tyre në nivel qarku, lidhur me menaxhimin e mbetjeve; Menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit; Goditjen e informalitetit në sektorin e furnizimit me ujë (në kuadrin e reformës së ndërmarrë nga qeveria); Goditjen e informalitetit në ustrimin e veprimtarisë së biznesit; Ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike; etj.

## V.1. Institucionet qendrore në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre

### V.1.1. Drejtoria Rajonale e Tatimeve

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 5,554,404 mijë lekë, ose 101,5 % e të ardhurave të programuara, me një tejkalim prej 84,403 mijë lekë (tejkallim i cili ka ardhur nga të ardhurat tatimore, pasi të ardhurat nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore ka një mosrealizim në shumën 35,173 mijë lekë) dhe me një rritje nga viti i kaluar prej 531,836 mijë lekë dhe viti 2016 prej 704,880 mijë lekë.

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2018, ka pësuar rritje me 257

Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, për kontribuesit, numri i të punësuarve për vitin 2018 dhe 2017 paraqitet:

Nr.	Emërtimi (sipas sektorëve dhe statusit)	Numri i të punësuarve, sipas vitit	
		2018	2017
1	Në sektorin publik	9,655	9,933
	a. buxhetor	9,206	9,478
	b. jobuxhetor	449	455
2	Në sektorin privat	22,055	21,520
	a. Subjekte të regj. si person fizik	7,973	8,028
	b. Subjekte të regj. si person juridik	14,082	13,492
	Nga të cilët:		
	- Vendase	12,278	11,395
	- Të përbashkëta	547	625
	- Të huaja	1,257	1,472
	Gjithsej	31,710	31,453

Të ardhurat e realizuara, numri i subjekteve të regjistruara i cili ka pësuar rritje, numri i të punësuarve (kontribuesve), i cili ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, tregojnë jo vetëm për masat e marra ndaj informalitetit, por janë tregues të përmirësimit të punës e performances së Drejtorisë Tatimore Rajonale

### **V.1.2. Drejtoria e hetimit tatimor (Rajoni Verior)**

Gjate vitit, nepermjet sektorit të zbatimit, janë ushtruar 2101 kontrole në subjektet e biznesit, në menyrë periodike mujore sipas planeve të punës të miratuara, me një vëmendje të shtuar gjatë sezonit turistik veror (Qershor-tetor);

Për gjetjet e rezultuara gjatë inpektimeve janë mbajtur 655 penalitete

Po kështu nepërmjet sektorit të hetimit janë referuar ne Prokurori 33 subjekte tregtare per vepra te ndryshme penale ne fushen e tatimeve dhe taksave, ose 12 referime më pak krahasuar me vitin e kaluar 2017

Gjatë vitit në funksion të veprimtarisë dhe zbatimit të detyrimeve ligjore është bashkëpunuar e njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet rajonale, bashkëpunim i cili ka qënë i mirë. Ndërsa me bashkinë Shkoder, bashkëpunimi duhet përmirësuar pasi ka mbetur vetëm në njoftime, lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitetet biznsi pa u regjistruar, kjo në veçanti për sezonin turistik

### **V.1.3. Dega e Doganës Shkodër**

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 3,260,906 mijë lekë, 93 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 234,059 mijë lekë, si dhe me një rënie nga viti i kaluar prej 788,094 mijë lekë. Ndërsa të ardhurat dytësore nga 22,328 mijë lekë janë realizuar 18,916 mijë lekë, ose 84.8 %, me një mosrealizim prej 3,412 mijë lekë

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për goditjen e fenomenit të fshehjes së detyrimeve doganore nga subjektet gjatë importit të mallrave, bashkëpunim i cili është reflektuar në treguesin e relizimit të të ardhurave.

### **V.1.4. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të ushqimit**

Puna e Drejtorisë është përqendruar e realizimin e planeve të Inspektimeve të miratuara nga DPAKU; Ne realizimin e detyrimeve të planifikuara të treguesve financiar; Ne zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit. Janë realizuar të ardhura me një vlerë prej 28,075 mijë lekë, me një rritje nga viti i kaluar prej 5,717 mijë lekë, ose 25.5 %.

Gjatë vitit janë kryer 687 inspektime nga 1976 inspektime të programuara për ty kryer në 1561 operator të biznesit ushqimor, ose 34.8 % e inspektimeve të programuara, kjo si pasojë e vendeve vakant (mungesës së numrit të punonjësve në fakt, sipas numrit dhe strukturës së miratuar). Nga inspektimet e kryera janë konstatuar dhe raste të mos përmbushjes së kërkesave ligjore:

- *Mungesë e kushteve higjieno sanitare*
- *Janë konstatuar raste të mungesës së gjurmshmërisë së produkteve.*
- *Mungesë etiketash në gjuhën shqipe.*
- *Mos plotësim i kërkesave ligjore për etiketimin e produkteve ushqimore*
- *Prodhim , përpunim i ushqimeve pa licencat përkatëse dhe pa QKR.*
- *Nxjerrje në treg ushqim i pasigurtë*

- *Tregëtimi i produkteve jashtë afatit të përdorimit,*
- *Tregtim mishi pa vulë e certifikatë vetrinere*
- *Tregtim i produkteve të Mbrojtjes së Bimëve pa licencë përkatëse*
- *Mos plotësim në tërësi të kushteve të mirëmbajtjes së plehrave të përdorimit për bimësinë etj.*

Për gjetjet e konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimeve, janë marrë masa administrative 274 raste, nga të cilat:

- Gjobë në 92 raste (nga të cilat janë arkëtuar 52 raste) me vlerë 21,620 mijë lekë;
- Ndërprerje të aktivitetit (bllokim) në 12 raste
- Paralajmërim, me qëllim eliminimin e parregullsive dhe shkeljeve të cilat nuk përbëjnë kundërvajtje administrative, në 170 raste
- Bllokim produktesh në një sasi prej 316924 kg (*Mish që tregtohej pa vulë, pa certifikatë veterinerë ose jashtë kushteve higjenike , peshk, tregtuar jashtë kushteve të higjenës , djathë pa dokumentacion shoqërues dhe rujtur në kushte të papërshtatshme higjenike , 80 kg kos rezultuar me ngarkesë mikrobike, lëndë e parë fruktozë e bllokuar e skaduar, 81 000 litra lëngje frutash bllokuar deri në përgjigjen e analizave dhe etiketave, si dhe produkte të tjera, makarona të skaduara, ushqime pa etiketa në shqip deri në paisjen me etikaeta, ushqime për blektori misër, hime miell bllokuar deri në marrjen e përgjigjeve të analizave etj)*
- Asgjësim i produkteve në një sasi prej 205826 kg (*mish që tregtohej pa vulë, pa certifikatë veterinerë ose jashtë kushteve higjenike , peshk, tregtuar jashtë kushteve të higjenës, djathë pa dokumentacion shoqërues dhe rujtur në kushte të papërshtatshme higjenike, 80 kg kos rezultuar me ngarkesë mikrobike, pije dhe ushqime të ndryshme nga të cilat 22380 litra lëngje frutsh, 121310 kg lëngje dhe ushqime të ndryshme makarona kroasant etj të asgjësuar për kalim të afatit të përdorimit, 40860 kg farëra jashtë norme me kërkesën e vetë subjekteve etj.)*

#### **V.1.5. Drejtoria e Rajonale e Shërbimit Kombëtar të punësimit**

Në fund të vitit janë regjistruar punëkërkuar të papunë 5329 persona (ku 58 % e punëkërkuarve të pa punë janë femra) nga 7055 persona të regjistruar në fund të vitit të kaluar, me një diferencë më pak 1726 persona, ose rreth 24 %. Rënie ka pësuar edhe numri i punëkërkuarve të papunë që trajtoheshin në skemat e mbështetjes me të ardhura nga buxheti i shtetit: ndihmë/ ekonomike dhe pagesë papunësie. Në fund vitit, në këtë skemë trajtohen gjithsej 1618 pu.pa, ndërkohë që në fund të vitit të kaluar në këtë skemë trajtoheshin 4060, me një diferencë më pak 2442 pu.pa., kjo edhe si pasojë e ndryshimit të kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike, sipas skemës së re

Oferta për punë në fund të vitit ka qenë 4182 persona, nga të cilët për vende të reja 2615 nga 2690 që ka qenë vitin e kaluar. Gjatë vitit janë punësuar 3246 pu.pa, nga të cilët

- Nëpërmjet zyrës së shërbimit të punësimit 1356 pu.pa (nëpërmjet nxitjes punësimit 245 pu.pa; me ndërmjetësim 1084 pu.pa. dhe zëvendësim 127 pu.pa.)
- Nga punëdhënësit 1352 pu.pa.
- Gjete punë vetë 537 pu.pa.

Vetëm për Shkodrën janë punësuar 2454 punësime, nga 1335 sipas planit të ardhur nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ose rreth 184 % e planit

Gjatë këtij viti, ashtu si edhe gjatë viteve të kaluara peshën kryesore të ofertave të punës e zënë ofertat fason dhe telemarketing, në një kohë që struktura e pu.pa. është jashtë kërkesave të tregut të punës

Në fund të vitit ka patur 1532 vende të lira pune, sipas fushave:

- Zejtar, zanatçinj e profesione të lidhura me to 1090, nga të cilët 1070 të përpunimit ushqimor, përpunim druri dhe tekstile
- Industri 67 (minierë e përpunim metali)
- Shitje e shërbime 314
- Me profesione elementare 5
- Forcat e armatosura 30
- Specialist, teknikë e nëpunës 26

Nisur nga detyrat funksionale (Shërbime të ndërmjetësimit, Shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme dhe punëdhënësit; Shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimit për punësim a vetëpunësim për punëkërkuesit; Shërbim e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë;Financim të punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar; Nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi;Formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuesit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë; Kryerja e studimeve të autorizuara të tregut të punës, etj.), gjatë vitit mbi bazën e planit të treguesve të monitorueshëm nga Drejtoria Përgjithshme, është hartuar plani i veprimeve për realizimin e treguesve, duke bërë një detajim me tregues për specialist, nga zbatimi i të cilit është konstatuar;

-Punësimi vazhdon të paraqesë vështirësi, pasi arsyeja objektive është : pesha e lartë specifike që zë fasoni ( rrobaqepsi, këpuçtari dhe përpunim peshku, kjo për Shkodrën) në strukturën e biznesit, pasi në këtë sektor kërkohen vetëm gra e vajza , duke mbetur në kuota pothuajse minimale ofertat e punës për punëkërkuesit e papunë meshkuj. Shkalla e punësimit për punëkërkuesit e papunë femra është mjaft e lartë. Një situatë e tillë mbetet problematike edhe në lidhje me plotësimin e vendeve të lira të shpallura nga subjektet e këtij sektori.

-Mosfunksionimi i rregullt i transportit urban (në oraret e fillimit të punës) në disa zona si Shiroka dhe Zogej. Ky fakt ka bërë që të kemi refuzime të vendeve të punës nga

pu.pa. që banojnë në këto zona me arsyen e mungesës së këtij transporti.

-Mungesa e çerdheve dhe kopshteve në zonat Shirokë, Zogej, si dhe në bashkinë Vau Dejës, që rrjedhimisht çon në refuzimin e punës nga pu.pa. me arsyen se nuk kanë ku i lënë fëmijët.

-Ushtrimi i funksioneve të zyrës së punësimit, pas futjes së vlerësimit të pretendentëve të ndihmës ekonomike me sistemin e pikëzimit, ka qënë shpesh edhe nxjerrja e mesazheve të gabuara në lidhje me statusin e punëkërkuësve të papunë, nga bashkimi i sistemit informatik të ndihmës ekonomike me sistemin informatik të shërbimeve të punësimit (si rezultat i ngarkesës së madhe të informacionit), gjë që ka cuar në penalizim të padrejtë “mospërfitimit të ndihmës ekonomike të familjes”, për gjoja mospasjen e statusit të punëkërkuësit të papunë.

Për kryerjen e veprimtarisë nga ana e Drejtorisë Rajonale të SHKP është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore dhe subjekte publike e jo publike, bashkëpunim që ka qënë i frytshëm, Kështu është bashkëpunuar me;

-Universitetin e Shkodrës, në lidhje me kryerjen e praktikave mësimore të studentëve; Organizimin e panairëve të punës, për praktikat mësimore të studentëve, si dhe praktikat profesionale (sipas VKM 873, të nxitjes së punësimit “Për studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë dy vitet e fundit”)

- Bashkinë Shkoder, për organizimin panairit të punës dhe bizneseve

- Institucionin e Prefektit, bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet institucioneve dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshi edhe çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

- Drejtorinë Tatimore Rajonale, për marrjen e informacionit periodik , në lidhje me numrin e të punësuarve, sipas deklarimeve në tatim taksa,

- DRShSSH, njësitë e vetëqeverisjes vendore, për raportimin dhe trajtimin e pu.pa (ish përfitues të nd.ek.)

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të SHKP gjatë vitit ka shqyrtuar edhe kërkesa dhe ankesa të ndryshme të shtatasve, apo institucioneve të ndryshme (Hapje karte shëndeti; Konfirmimi i statusit si i papunë; Bursa studimi për fëmijët; Bashkime familjare me fëmijët në emigracion; etj, duke qënë dhe për të gjithë këto raste kërkohet konfirmimi si i papunë, megjithëse kerkuesit nuk kërkojnë punë, pra nuk janë të rregjistruar si kërkues për punë; Ankesa nga pu.pa.” Ish përfitues të ndihmës ekonomike”)

#### **V.1.6. Inspektoriati Shteteror i Punes dhe Sherbimeve Shoqerore**

Nga ana e IShPShSh, për kryerjen e veprimtarisë dhe për çështje me objektiv të përbashkët, është bashkëpunuar me institucionet rajonale Tatimore dhe të Hetimit Tatimor Rajoni Verior, Qëndren Kombetare të Biznesit, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Policinë Vendore, Spitalin Rajonal, Sigurimet

Shoqërore, etj.

Gjatë vitit kanë kërkuar autorizim, duke u ngarkuar në portal, 802 subjekte, për të cilat janë pas shqyrtimit janë dhënë vendime përfundimtare për 800 subjekte

Jane kryer 806 inspektive (nga 640 të planifikuara), nga të cilat 325 inspektive tematike (164 inspektive gjatë sezonit turistik dhe 142 inspektive këshilluese), për shkak të aksidenteve/ngjarjeve në punë 8 inspektive, verifikim ankesa 21 inspektive, etj.

Nga inspektimet e kryera ka rezultuar:

- Punëmarrës me dëmtime të lehta nga aksidentet në punë (paaftësi për punë 1-14 ditë) 11, për të cilat janë paralajmëruar 5 subjekte, ndërsa ndaj një subjekti është marrë masë administrative me gjobë me vlerë 480 mijë lekë
- Punëmarrës të padeklaruar 224, të cilët janë futur menjëherë në shkemen e sigurimeve.
- Punëmarrës pa kontratë individuale 395
- Punëmarrësit e paguar me page minimale 6663
- Shkelje ligjore për shëndetin dhe sigurinë në punë 668 raste

Për shkeljet e legjislacionit të punës, të gjetura nga inspektimet e kryera, janë marrë masa:

- Paralajmërim për sanksion me gjobë 19 subjekte
- Vendosje gjobë 7 subjekte në shumën 1,450 mijë lekë
- Rekomandim për eliminimin e shkeljeve të vertetuara, lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë

#### **V.1.7. Drejtoria e Bujqesise (Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor)**

Drejtim kryesor i këtij i veprimtarisë është rritja e efektivitetit të shërbimeve të ekstensionit për këshillim, trajnim dhe sigurim informacioni në Qendrat e Informacionit Bujqësor e më gjerë, nëpërmjet realizimit cilësor të programeve dhe aktiviteteve të planifikuara, në përputhje me prioritetet dhe tendencat e zhvillimit të bujqësisë, politikave dhe strategjive të MBZHR

Gjatë vitit në territorin e qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashki, Nj.A e fshatra) janë evidentuar me kartelë 38000 fermerë. Siperfaqja e tokës bujqësore në qark është 46,115 Ha, nga të cilat tokë arë 42,522 dhe pemë frutore 3,593 Ha.

Prioritet kryesor i punës të sektorit është zbatimi i politikave të qeverisë mbi skemat kombëtare në bujqësi dhe shpërndarjen e informacionit për masat e mbështetjes dhe kriteret e përfitimit të projekteve nga fermerët. Kanë aplikuar gjithsejt **433** projekte (**280** projekte në bujqësi për mbjellje të reja dhe ujitjen me pika; **153** projekte në blegtori për dorëzimin e qumështit dhe stimulimin e matrikullimit të imtave nga specialistet e Sektorit këshillimor në bashkepunim me AZHBR-në). Risi gjatë vitit ka qenë reduktimi i dokumentacionit të aplikimit, duke aplikuar vetëm me 2 dokumentë, megjithatë problem mbetet Çertifikata e pronësisë

Nga shërbimi këshillimor janë kryer 4173 aktivitete të ndryshme (Prioritetet dhe objektivat e ekstensionit; Takime individuale të ekstensionistëve; Vizitor në qendrat e informacionit; Demonstrime fushore; Ditë Fushore; Takime në grupe dhe tryeza të rrumbullakëta; Vizita në fermë; Trajnime të specialistëve dhe fermerëve; Emisione dhe rubrika në TV; Buxhetimi në fermë; Monitorime; Shpërndarje fletëpalosje e broshura; Vizita në ferma e fermerë, përfitues nga skemat mbështetëse, etj), me mosrealizim nga plani i miratuar që ka ardhur nga mungesa e punonjësve (ekstensionistëve), mosplotësimi i numrit sipas strukturës së miratuar

Është punuar edhe në përgatitjen e raporteve vjetore statistikore, kryerjen e vrojtimit dhe listimit për agroindustrinë, vrojtimi për serat, marrja e çmimeve ditore në tregjet e shumicës dhe pakicës, evidentimi i mbjelljeve të pranveres dhe të vjeshtës, parashikimi i I-rë dhe i II-të i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, evidentimi i potencialeve prodhuese për prodhimet bujqësore dhe blegtorale, realizimi i Vrojtimi Bujqësor dhe hedhja e të dhenave nga formularët në programin elektronik statistikor; si dhe në zbatim Udhëzimit Nr.19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësore për qëllim të tatimit mbi vlerën e shtuar” fermerët janë pajisur me vërtetim për pajisjen me NIPT (Numri i aplikimeve për NIPT ka qënë 419, nga 563 që ka qënë vitin e kaluar)

Jane pajisur me çertifikatë (sipas ligjit për Mbrojtjen e Bimëve), të cilat zgjidhin problematikën e nevojat e fermerëve, në rritjen e nivelit të trajnimeve të specialistëve dhe të fermerëve, në rritjen e bashkëpunimit me projektet, fondacionet dhe organizatat me aktivitet në qark, në nxitjen e inisiativave për kooperim të fermerëve, në përdorimin me efektiv të medias për pasqyrimin e aktiviteteve dhe përhapjen e mesazheve të ekstensionit. Janë pajisur me çertifikatë eksporti 177 fermerë, çertifikatë riekspor e të brendshme 10

Është monitoruar situata fitosanitare në pergjithësi dhe për parazitet karantinore në veçanti, fermeret dhe subjektet e interesuara janë asistuar edhe nëpërmjet ekspertizës, analizave laboratorike dhe vizitave direkte në fermë për problematikën e shfaqur. (Informacioni është siguruar nga ekstensionistet e QIB-ve, bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe me fermerë të interesuar)

Gjatë vitit janë eksportuar 658 ton sherbelë, bimë të ndryshme medicinale 122 ton, fruta e perime 32 ton, fidana dekorativ 135,345 copë

Për kryerjen e veprimtarisë është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata dhe fermerë, bashkëpunim i cili ka qënë i mirë, veçanërisht ;

- Në përballimin e situatës emergjente të krijuar nga reshjet dhe përmbytjet e muajit Mars ku u përmbytën rreth 3607 ha tokë (42 ha Grurë, 393 ha Foragjere, 1377 ha Jonxhë, 1723 e pakultivuar, 58 ha Bime dekorative 13 ha te tjera)

- Përballimin e emergjencave nga zjarret në muajin Gusht (10 Gusht në fshatin Kullaj, Nj.A Postrisë, ku janë djegur në masen 80 % 14 dy me 340 rrënjë ullinj) dhe Tetor (16 Tetor në fshatin Zues të Nj.A Rrethina nga zjarri i rënë në një sip. Prej 100 Ha me 35000 rrenjë ullinj, janë dëmtuar 17000 rrënjë; tokë pa dokumentacion dhe që shfrytëzohet nga 20 familje)

- Në zbatimin e planit të veprimit kundër kultivimit të kanabisit
- Për realizimin e aktiviteteve me përparësi agroturizëm, kryesisht në fshatrat turistike

(10 fshatra në qark, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore);

- Identifikimin e fermave me prodhime autoktone, te cilat janë një potencial tradicional, etj.

#### **V.1.8. Drejtoria e ujitjes dhe kullimit Lezhë**

Në ushtrimin e veprimtarisë ka koordinuar punën me njësitë e vetëqeverisjes për pastrimin e rrjetit të kanaleve ujitëse e kulluese, sidomos të rrjetit kullues për menaxhimin sa më të mirë të situatës në kohë rreshesh dhe në ato njësi e zona ku ka patur probleme vitet e kaluara. Gjatë vitit me fondet e buxhetit është ndërhyrë për përmirësimin e sistemit të ujitje dhe kullimit në territorin e bashkisë Shkodër (Kanali i ujitjes Rragam); në bashkinë Vau i Dejës (Kanali i Ujitjes Mjedë-Koterr; Kanali i Ujitjes Mjedë-Kosmaç; Në territorin e bashkisë Shkoder, Mbrojtje nga gërryerjet e lumit “Buna” në Nj.A Oblikë), si dhe nga përmbytjet (pastrim i kanalit kullues Ura e Gjon Lulit-Vilu)

#### **V.1.9. Agjencia e Basenit Ujor Drin-Bune**

Veprimtaria e Agjencisë mbështetet në Ligjin Nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si dhe planeve të punës të hartuara e miratuara, sipas problemeve të veçanta

Gjatë vitit janë zhvilluar 5 mbledhje të Keshillit të Basenit Ujor Drin-Bune, në të cilat janë marrë 42 vendime, nga 74 projekt vendime të paraqitura. Është bërë kontrolli i të gjitha dosjeve të subjekteve të cilat kanë aplikuar për leje dhe autorizim të përdorimit të rezervave ujore të ABU, duke u kthyer përgjigje lidhur me gjetjet

Jane ushtruar 156 kontrole, lidhur me përdorimin e burimeve ujore

Në zbatim të Urdhrit Nr. 228, datë 01.12.2017 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit qendror ndërinstitucional të punës dhe të grupeve vendore të punës, për ndërhyrjet ndaj shfrytëzimit dhe gërryerjeve të brigjeve të lumenjve”, pika 5 dhe të planit vendor të punës janë ushtruar 36 kontrole në pika të ndryshme, të evidentuara nga STKKU

Gjatë vitit është kërkuar bashkëpunim nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, lidhur me evidentimin e përdoruesve të ujit pa leje

#### **V.1.10. Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit**

Dega Rajonale e ISHMPU, gjatë vitit me qellim garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së pyjeve në qark (Mbrojtja e flores dhe e faunes si dhe mbrojtja në pergjithësi e mjedisit pyjor; Parandalimi i dëmeve në pyje; Zbatimi i moratoriumit), nepermjet Sektorit të Inspektimeve, ka kryer 368 inspektime, nga të cilat:

- Në fond pyjor e rrugë automobilistike 320
- Subjekte publike e private 30
- Gjueti 12



Nga inspektimet janë gjetur 3528 copë drurë të llojeve të ndryshme me volum total prej 2150 m<sup>3</sup>, nga të cilat me procesverbal 59 copë në një sasi prej 19.3 m<sup>3</sup> dhe pa procesverbal 3469 copë me 2130 m<sup>3</sup>:

Për gjetjet e konstatuara gjatë inspektimeve janë marrë masa

- Sekuestrim materiali drusor në 31 raste në një sasi prej 2147 m<sup>3</sup> (27 raste dru zjarri me 1876 m<sup>3</sup> dhe 4 raste lëndë punimi me 271 m<sup>3</sup>), nga të cilat në rrugë 20 raste me një sasi prej 103 m<sup>3</sup> dhe në pyll 11 raste me sasi 2044 m<sup>3</sup>

-Gjobë në 16 raste me vlerë 11,220 mijë lekë dhe vlerë dëmi 485 mijë lekë

Gjatë vitit nga ana e Degës është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet rajonale, për parandalimin e dëmeve në pyje përfshi edhe zjarret e rena

Ne territorin e qarkut janë shfaqur vatra zjarri në 34 raste (19 raste në pyje dhe 14 raste në kullota) nga 73 raste të shfaqura vitin e kaluar (49 raste në pyje dhe 24 në kullota), duke përshkruar 1735. 2 Ha dhe djegur plotësisht 11.81 Ha (Nga 1602.9 Ha të përshkuara në vitin e kaluar dhe 804.7 Ha të djegura vitin e kaluar), me një dëm ekonomik me vlerë 5,741 mijë lekë: sipas bashkive;

a. Bashkia Pukë dhe Fushë Arrëz

Numuri rasteve të zjarreve të rena 19 gjithsejt me sipërfaqe 1696 ha të përshkruar dhe djegur 9.31 ha (Zjarret e rena kanë demtuar me teper pyjet e larta trungishte me halore të Ekonomive pyjore të Tucit, Lume Bardhes dhe të Lum Zi)

b. Bashkia Shkodër

Numuri rasteve të zjarreve të rena 12 gjithsejt me sipërfaqe 8.2 ha përshkrim në shkurre kallamishte dhe kryesisht në Zona të Mbrojtura Velipoje e PK Theth

c. Bashkia Malesia Madhe

Numuri i zjarreve të rena 2 raste në një sip. prej 6 ha përshkrim sip. Inproduktive Ekonomia Pyjore Koplík-Gruemirë

d. Bashkia Vau Dejës

Në 1 rast në një sip. prej 25 ha përshkrim ndërsa sipërfaqja e djegur është 2.5 ha shkurre.

#### **V.1.11. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik**

Objektivat vjetorë për formim profesional në përshtatje me kërkesat dhe nevojat e tregut rajonal të punës, nepermjet hapjes dhe zhvillimit të 24 llojeve të kurseve profesionale afatshkurtëra (nga të cilat 12 janë planifikuar dhe zhvilluar në ambientet dhe laboratorët e qendrës), gjatë këtij vitit janë përcaktuar në bashkëpunim me Zyrat Vendore të Shërbimit

Nga 732 persona të planifikuar për tu regjistruar në kurset e formimit profesional, në qendren e formimit, janë regjistruar 771 persona (në 12 kurse të ndryshme profesionale dhe komplementare). Ndërsa në 12 kurset e tjera të planifikuara për tu zhvilluar në bashkëpunim me zyrat e punësimit, bizneset dhe shkollat profesionale, u realizuan vetëm 3 prej tyre dhe nga 286 regjistrime u realizuan vetëm 116 prej tyre. Shqetësim serioz ka qënë dhe mbetet

veçanërisht mosrealizimi i kurseve në fushën e hoteleri-turizmit për profilet: kuzhinier, banakier, kamarier, drejtues në hotele e restorante dhe guidë turistike. Ky mosrealizim vjen kryesisht për shkak të mosrealizimit të marrëveshjeve me Shkollën profesionale teknologjike, pasi ka munguar e vazhdon të mungojë baza ligjore për arritjen e këtyre marrëveshjeve. Për këtë arsye është kërkuar planifikimi e realizimi i një investimi për ngritjen e laboratorit të kuzhinës në ambientet e Qendrës së formimit. Po kështu, për kurset në profile të tilla si: saldator, mobilier, marangoz, teknik ashensorësh, bojaxhi makinash etj., vlerësohet që Zyrat e punësimit duhet të kenë një angazhim më konkret për të mundësuar marrëveshjet me bizneset për realizimin e këtyre kurseve, te cilat për vitin 2018 nuk u realizuan për shkak të mosarritjes së këtyre marrëveshjeve.

Bashkëpunimi me institucionet qendrore në nivel vendor, veçanërisht me Zyrat e Punësimit Shkodër, Malësi e Madhe, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Inspektoriatin Shtetëror të Punës, si dhe Shërbimin e Provës, etj. ka qenë sistematik dhe efektiv.

#### **V.1.12. Arsimi**

Gjatë vitit me fondet e buxhetit dhe të bashkive është bërë përmirësimi i infrastrukturës, ndërtim dhe rikonstruksion në 27 shkolla, sipas bashkive;

- a. Malësi e Madhe 6 (Shkolla e mesme “Sherif Hoxha”, ”Dedë Gjonluli, “Vasil Shanto” Vrakë, “Muhamet Hasmuja”, “Rifat Nuzi”, Rec, cikli fillor Kçar i Poshtem
- b. Shkodër 14 (Shkolla “Nikoll Zagorjani” Velipojë, “28 Nentori”, “Oso Kuka”, “Azem Hajdari”, “Ismail Qemali”, “Veli Tela”, “Haxhi Hajdari”, “Tring Smajli”, “At Gjon Karma” Guri i Zi, Kuc, “Agim Tafili” Berdice, Kullaj, “Mati Logoreci”)
- c. Vau i Dejës 4 (Shkolla “Mark Çuni”, Rranza, Mesme e bashkuar Pistull, Mnele
- d. Pukë 1 (Shkolla e mesme “Sabah Sinani” Pukë)
- e. Fushë Arrëz 2 (Shkolla 9-vjeçare “Pjeter Arbnori” Fushë Arrëz dhe Berishë e Vogël)

Janë në rikonstruksion 2 shkolla në bashkinë Fushë Arrëz (me fondet e buxhetit të shtetit), Shkolla e mesme “70 vjetori i Pavarsisë” (me vlerë 67,669 mijë lekë) dhe Shkolla 9-vjeçare Iballë, Nj.A Iballë (me vlerë 21,078 mijë lekë)

Me ndërhyrjet e bëra në infrastrukturë, sigurimin ngrohjes në të gjitha shkollat, ofrimin e shërbimit të internetit (në 64 shkolla) janë përmirësuar kushtet për zhvillimin e një procesi normal mësimor në të gjitha shkollat. Janë krjuar struktura mbështetëse për zhvillimin e mësimin nxënësve me aftësi ndryshe (Janë caktuar mësues mbështetës për zhvillimin normal të procesit mësimor të nxënësve me aftësi ndryshe)

Nuk ka nxënës, të cilët nuk frekuentojnë mësimin për shkak të fenomenit të gjakmarrjes (vitin e kaluar ka patur 5 nxënës). Personeli mësimor është me arsmin përkatës, sipas profilit të mësimdhënies

Gjatë vitit arsimor 2018-2019 janë regjistrua e frekuentojnë mësimin 33073 nxënës, në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar publik e jo publik, nga të cilët 2105 janë ulur për herë të parë në bankat e shkollës (në klasën e I-rë)

Për shkak të ngarkesës (Numrit të madh të nxënësve dhe mungesës së ambienteve) procesi mësimor zhvillohet me 2 turne, në 4 shkolla të qytetit Shkoder (Në shkollën 9-vjeçare “Ismali Qemali”; 9-vjeçare “Branko Kadia”; 9-vjeçare “Ndre Mjeda”; 9-vjeçare “Xheladin Fishta”). Po kështu për shkak të rikonstruksionit;

- Për nxënësit e shkollës Iballë mësimi zhvillohet në ambientet e Nj.A Iballë
- Për nxënësit e shkollës mesme Fushë Arrëz, mësimi zhvillohet në shkollën 9-vjeçare “P.Arbnori” (turn II-të) Fushë Arrëz

Nga ana e DAR, për të vlerësuar situatën, me synim sigurimin e një arsimit të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e kurrikulës në shkolla në funksion të rritjes dhe garantimit të cilësisë së arsimit dhe zbatimin e strategjive kombëtare, gjatë vitit ka kryer monitorime të institucioneve arsimore, për;

- Sigurimin e rregjistrimit të gjithë nxënësve, sipas procedurave ligjore;
- Zbatimin e kurrikulave në shkollat, për fushat: kurrikula e zbatuar; mësimdhënia dhe të nxënësve; vlerësimi; klima dhe etika, kujdesi ndaj nxënësve;
- Mësimdhënien nga mësues me arsimin e lartë sipas profilit që kërkon vendi i punës;
- Punësimin e mësuesve mbi bazën e një konkursi i cili teston realisht njohuritë e tyre duke përzgjedhur në kohe reale dhe transparente konkurrentin me njohuri me të mire për çdo vend pune;
- Zhvillimi i mësimin në kushte me bashkëkohore, digjitalizimi
- Sigurimin dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve me Aftësi ndrshe dhe të komunitetit rom/egjiptian (gjatë vitit frekuentojnë mësimin 145 nxënësve me AK, 404 rom dhe egjiptiane), duke ofruar dhe shërbim mbështetës përmes mësuesve ndihmës;
- Regjistrimin dhe frekuentimin e nxënësve në situatë rruge (gjatë vitit është arritur që asnjë nxënës të mbetet në situatë rruge dhe jashtë frekuentimit të shkolles);
- Sigurimin e një përzgjedhje transparente dhe shpërndarje të teksteve shkollore falas për nxënës të kl 1-4 dhe kategorive të tjera të percaktuara me ligj;
- Mirëmenaxhimin e procesit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në Arsimin fillor, Provimeve të Lirimit, të Maturës Shtetërore dhe të shkollës me kohë të pjesshme;
- Zbatimin e detyrimeve ligjore në dobi të mirëfunksionimit të IA;
- Zbatimin e standardeve në shkolla qendra komunitare;
- Implementimin e projektit “Bëjmë detyrat e shtëpisë” në 5 shkolla (projekt i cili po zbatohet me sukses);
- Krijimin dhe funksionimin e klasave sportive (Janë krijuar dhe funksionojnë 13 klasa sportive në shtatë shkolla)
- Menaxhimin e procesit të praktikës profesionale;
- Ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve profesionale (Jane ngritur dhe po mirëfunksionojnë rrjetet profesionale duke bere që mësuesit të zhvillohen profesionalisht përmes ndarjes së eksperiencave apo zgjidhjes së problematikave të hasura gjatë procesit mësimor);
- Rankimin e shkollave, sipas kartës së performancës (Është realizuar procesi);

Për eliminimin e parregullsive dhe gjetjeve të rezultuara nga monitorimi janë dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilave është ndjekur në vazhdimësi:

Për kryerjen e veprimtarisë, sigurimin e zhvillimit normal të procesit mësimor, brenda standardeve të kërkuara, është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata të ndryshme që operojnë në qark, si dhe komunitetin, bashkëpunim i cili mirë; Kështu është bashkëpunuar me,

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e infrastrukturës (Ndërtim, rikonstrukcion, rrethim, mirëmbajtje e lysterje të ambienteve të shkollave, krijimin e ambienteve të pastra jo vetëm në ambientet e shkollave, por edhe oborreve të tyre); për funksionimin e grupeve multidisiplinare (duke bërë zgjidhjen e të gjitha rasteve specifike); Regjistrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë, etj.

- Drejtorinë Rajonale të ShSSH, për regjistrimin e 129 fëmijëve në situatë rruge si dhe sigurimin e transportit dhe bazës materiale shkollore; Për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të ditëve ndërkombëtare;

- Drejtorinë Vendore të Policisë, për Zbatimin e Programit “Edukimi, ndergjegjesimi dhe reduktimi i kërkesës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”; Kooordinim dhe mbështetje mbi bazën e një plani veprimi kundër trafikimit të qenive njëzore; Sigurimin e mbarëvajtjes së provimeve; Sigurimin e rendit dhe qetesise në ambientet përreth shkollave

- Institucionin e Prefektit, për Kooordinimin ndërinstitucional mbi bazën e një plani veprimi kundër trafikimit të qenive njëzore dhe ekstremizmit të dhunshëm; Marrjen e masave për zbatimin e detyrimeve ligjore të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore në krijimin e një infrastrukture të përshtatshme, sigurimin e ngrohjes, regjistrimin e fëmijëve dhe zhvillimin normal të procesit mësimor, brenda standardeve dhe kushteve të përcaktuara; Për përballimin e emergjencave civile në menaxhimin e situatave që krijohen nga temperaturat e ulta, përmblytjet, reshjet e dëborës, etj.

- WORLD VISON, Permesmarëveshjes dypalëshe dyvjeçare 2017-2019 ku prashkohet realizimi i programeve të Edukimit, Mbrotjtjes së Fëmijëve në IA që i perlkasin Nj.ARrethina, Ana e Malit (fshati Oblike) si dhe në 4 lagje të qytetit (Guerrile, Mark Lula, Lirie dhe Rus), Si dhe SHQK për procesin e vetëvlersimit të treguesve të standardeve të shkollave SHQK si dhe në zbatimin e standardeve në këto shkolla

- SAVE THE CHILDREN, për sigurimin e gjithëpeshirjes së komunitetit rom dhe egjiptian;

- OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE, për Sigurimin e frekuentimit të çdo fëmije në shkollë; Ndërgjegjesimin e komunitetit për domosdoshmërinë e frekuentimit të shkolles nga fëmijët e tyre;

- Me organizata e shoqata të tjera vendore, si SOS fshatrat e femijeve ,YWCA Terres des Homme Malteser, Gruaja të grua, Gruaja në integrim

Nga ana e DAR vemëndje i është kushtuar edhe shqyrtimit të kërkesave dhe ankesave të ndryshme të shtetasve, apo institucioneve të ndryshme (Ofrimin e shërbimit për legalizim dokumentacioni shkollor; sigurimin e vazhdimin të procesit mësimor për fëmijët, failjet e të të cilëve janë kthyer nga emigracioni, për 233 femije të kthyer gjatë vitit 2018; Sigurimin e aksesit për organizatat që operojnë në shkollë; Sigurimin e cilësisë në IA jo publike; etj.)

### **V.1.13. Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare Shkoder**

Gjatë vitit 2018 janë kryer punime mirëmbajtje dhe konservimi në 6 objekte brenda territorit të qarkut Shkodër (Kalane e Shkodres dhe të Drishtit; Banesën e Pashko Vasës dhe

Filip Cekës; Objektet e kultit-Kishën e Shën Gjergjit në Shirgj dhe Kishë-xhami në Kalanë e Shkodrës)

Janë botuar flet-palosje në dy gjuhë për Kalanë e Shkodrës, sitin Arkeologjik të Komanit, të cilat u shpërndahen vizitorëve gjatë vizitave të tyre

Gjatë vitit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura, në kuadrin e projektit është instaluar edhe në Kalanë e Shkodrës Smile Albania, duke mundësuar shoqërimin e turistëve dhe vizitorëve të cilët nuk vijnë të organizuar me guida. Ne kete kuader janë pergatitur dhe deguar per miratim ne Institutin e Monumenteve te Kultures Tirane, 30 panele informuese, të cilat do të vendosen ne objekte me status "Monument" me potencial vizitueshmerie

Si rezultat i masave të marra (përfshirë edhe funksionimin normal gjatë gjithë vitit, të sistemit elektronik të biletarisë), është rritur numri i vizitorëve në Parkun Arkeologjik Shkoder (Kalanë "Rozafa"), duke arritur gjatë vitit në një numer rekord prej 102296, ose krahasuar me vitin e kaluar rreth 2 herë më shumë. Në numrin e vizitorëve dhe turistëve, vlen për tu përmendur fluksi turistik i ri nga vende edhe më të largëta si Izraeli, Ukraina, Malajzia. Si rezultat i rritjes së numrit të vizitorëve, janë rritur edhe të ardhurat, nga shitja e biletave. Gjatë vitit janë realizuar të ardhura me vlerë 13,295 mijë lekë nga 10,000 mijë lekë të programuara, me një tejkalim prej 3,295 mijë lekë, ose rreth 33 %. Jane hartuar dhe zbatuar projekte ne konservim dhe restaurim monumentesh ne kalane e Shkodres.

Nder problematikat e shfaqura gjatë sezonit ka qenë vështirësia e zbatimit të Ligjit të Turizmit për guidat e licënuara dhe të autorizuar nga Ministria e Turizmit, duke qenë se Shkodra pjesën më të madhe të fluksit turistik e ka nga vendet lindore qe pushojnë gjatë sezonit veror në Mal të Zi dhe për vetë specifikën që gjuhët e këtyre grup vendesh nuk studiohen (kryesisht gjuha ruse) ka sjellur vështirësi për agjensitë turistike për të patur shoqërues, guide, për këto grupe.

Për përmirësimin e veprimtarisë dhe performancës së institucionit rekomandohet:

- Shtim të numrit të punonjësve, duke përfshirë "lektor" ne Kalane e Shkodres, duke mbuluar keshtu, problematiken e shoqerimit te turisteve qe vizitojne kalane pa guide te tyre.
- Brenda strukturës të krijohet dhe të funksionojë një sektor, për të mbuluar programin e edukimit nepermjet kulturës, si një program prioritar
- Programimin dhe zhvillimin e trajnimeve te perbashketa te specialisteve te edukimit dhe mesuesve qe japin lenden e trashigimise kulturore dhe arteve
- Të rritet niveli bashkëpunimit me DAR Shkoder, duke programuar e zhvilluar orë të veçanta mësimi nga vetë shkollat
- Krijimi i mundësive për aplikim në kuadrin e projekteve, drejtpërdrejtë tek donatorët brenda apo jashtë vendit

## V.2. Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim

Gjatë vitit krahasuar me vitin e kaluar 2017 kriminaliteti është ulur në masën 1 %, ose me 14 vepra penale më pak (Nga 2306 vepra penale të evidentuara gjatë vitit 2017 në vitin 2018 janë evidentuar 2292)

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2018 e 2017, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	
			2018	2017
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në prokurori	Numër	2292	2306
2	Vepra penale për të cilat janë zbuluar autorët	“	2050	2016
3	Persona të implikuar,	“	3632	2520
	Nga të cilët			
	-U është privuar liria (arrestuar)	“	562	723
	-Janë ndaluar	“	130	218
	-Janë ndjekur në gjëndje të lirë	“	2274	1370
	-Janë shpallur në kërkim, pasi janë larguar, apo i fshihen drejtësisë	“	158	202
	-Kanë ndërruar jetë (në rrethana të vërtetuar proceduralisht)	“	8	7

Gjatë vitit nga shërbimet policore janë evidentuar dhe referuar në prokurori 2292 vepra penale. Nën drejtimin e prokurorive të rretheve gjyqësore nga veprimtaria hetimore-gjurmuese shërbimet policore kanë arritur të mbledhin fakte dhe prova, duke zbuluar e dokumentuar autorësinë e 2050 veprave penale, me një zbulueshmëri 89.4 % nga 87.4 % që ka qenë vitin e kaluar.

Gjatë vitit nga ana e shërbimeve të policisë është rritur niveli i bashkëpunimit me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet publike e private, si dhe me komunitetin në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, duke qënë në mbështetje të për të gjitha problemet dhe vështirësitë e hasura në zbatimin e detyrimeve ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë

Nga Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit gjatë vitit vëmendjen e ka përqendruar në drejtim të kontrollit të kufirit, parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të kundraligjshme që mund të zhvillohen nepermjet kufirit shtetëror, menaxhimin e fluksit të lëvizjeve të shtetasve dhe mjeteve nepermjet pikave të kalimit kufitar si dhe sigurimin e rendit dhe qetesise publike gjatë sezonit turistik 2018. Prioritet ka qenë goditja e trafikut të narkotikeve, kalimi i pa ligjshëm i kufirit, peshkim i ndaluar dhe fallsifikim i dokumentave.

Në menyrë të veçantë, gjatë sezonit turistik, është bërë një punë shumë e mirë nga të gjitha shërbimet e Policisë Kufitare të DVKM-së Shkodër mbi marrjen e masave organizative “Për garantimin e rendit dhe sigurisë publike në zona turistike dhe plazhe, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe menaxhimin e hyrje/daljeve në kufi, pasi gjatë sezonit turistik veror 2018 është rritur fluksi i lëvizjes së njerzëve dhe mjeteve, krahasuar me vitin e kaluar. Për menaxhimin sa më mirë të fluksit të lëvizjes së njerzëve dhe mjeteve, kryerjen e

shërbimit pa krijuar radhë të gjata, në P.K.K Muriqan e Hani i Hotit dhe Bashkim, janë shtuar postet e punës. Është bashkëpunuar me drejtuesit e Agjensive Turistike që shtrijnë veprimtarinë e tyre nëpërmejt pikave të kalimit në juridiksionin e DVK&M Shkodër, me qëllim shkëmbimin e informacioneve për regjimin e hyrje/daljeve të shtetasve të huaj dhe shqiptar. Po kështu është bashkëpunuar me organet doganore për përmirësimin e infrastrukturës në PKK, për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale, vijëzimin e rrugëve dhe ndriçimin e novojshtëm, për të orjentuar levizjen e sigurtë të turistëve, nga hyrja deri në dalje të P.K.K-ve.

### **Rekomandime për përmirësimin e punës**

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor, duke krijuar struktura (grupe ndërinstitucionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre, ku kërkohet një bashkëpunim më intensiv me administratorët e njësive administrative, të lagjeve dhe kryetarët e fshatrave për evidentimin, njohjen dhe identifikimin jo vetëm të zonave me risk të kultivimit të bimëve narkotike por edhe të personave tashme të skeduar nga policia, të cilët duhet të jene edhe në siten e skanimit të drejtuesve të institucioneve të të gjitha niveleve

Në luftën goditëse ndaj bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e rreptë dhe e vazhdueshme në Menaxhimin e burimeve njerëzore, që merret me aktivitetin e paligjshëm të bimëve narkotike, sipas periudhave (Në periudhën përgatitore dhe kultivimit, që nga punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm) dhe njësive administrative e fshatrave (Ato Nj. A, fshatra, zona dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike)

b. Përmirësimin e sinjalistikës rrugore dhe disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësive të vetëqeverisjes vendore (*Shmangia e shërbimeve të policisë rrugore nëpërmjet postbllloqeve të ngritura në çdo kohë dhe vënd pa vënd, të cilat shpeshherë rëndojnë trafikun, por çka është me rëndësishmja krijojnë një imazh jo të mirë edhe për shërbimin policor*)

c. Hartimin e planeve të përbashkëta operacionale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella për parandalimin, ndërhyrjen dhe menaxhimin e situatave të emergjente.

d. Hartimin e planeve të përbashkëta, në zbatimin e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme (kulturore, sportive, etj), tubimeve, apo në raste festash kombëtare e lokale.

e. Hartimin e planeve të përbashkëta dhe mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore, Degëve Territoriale, operatorëve turistik, etj. në marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik

2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Drejtorinë Rajonale, zyrat arsimore, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por as jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i riskuar.

3. Bashkëpunimi me institucionet e kultit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe organet e drejtësisë, për evidentimin e personave me tendencë terroriste, apo propaganduese e bashkëpunuese me strukturat e ISIS

### **V.3. Problemet e konstatuara nga analizat mujore të punës të institucioneve qendrore në nivel vendor**

**Nga analizat e veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, janë konstatuar:**

Problemet e pronësisë mbi tokën bujqësore, e cila veç të tjerave ka sjellë edhe pamundësinë e përfitimit të financimit të fermerëve, nga ana e buxhetit (subvencionimi në kultura bujqësore, ose lloje të gjësë së gjallë)

Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe nje sfide vecanerisht per zonen periferike te qytetit Shkoder, perfshi njesite administrative Rrethina, Postribe, Ana e Malit, Gruemire, Guri Zi, etj. Megjithe masat dhe permiresimin e sherbimit, akoma mbeturinat digjen ne zona te caktuara dhe bile edhe brenda kontinjerve (kazaneve) duke u bere shkak i rritjes se semundshmerise se qytetarve me ndotjen e mjedisit. Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime të pamiratuara (ose të miratuara nga bashkitë) për bashkinë Malësi e Madhe, Pukë e Fushë Arrëz

Përmirësimi i nivelit të shërbimit të furnizimit me energji elektrike, në menyrë të veçantë i zonave të thella malore gjatë periudhës së dimrit

### **V.4. Grupet e punës ndërinstitucionale (task-forcat)**

Prefekti i qarkut ka drejtuar grupet ndërinstitucionale (task forcen vendore), duke qenë pjesë përbërëse e tyre, për:

Koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të



kanabisit, si dhe monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit

Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

Monitorimin dhe kontrollin e masave, për zbatimin e detyrimeve ligjore për sigurinë në plazhe

Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2018”

Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Menaxhimin dhe përballimin e situatave emergjente në qark, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Shfrytëzimin e inerteve në brigjet e lumenjve

Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private (Bashkëpunim për ngritjen e grupeve të përbashkëta të patrullimit në postblloqe fikse si dhe ato të lëvizshme për parandalimin dhe ndëshkimit të rasteve të transportit të kundërligjshëm të lëndës drusore e deri në kontrollin e befasishme dhe të programuara në zona pyjore me problematike për dëme në fondin pyjor, Bashkëpunim i cila ka dhënë rezultatet e veta pozitive, për disiplinimin dhe venien nën kontroll të prerjeve abuzive të druveve pyjore dhe transportit të paligjshëm të tyre, Po kështu janë marrë masa për mbrojtjen nga gjuetia e paligjshme, duke përqendruar vëmendjen për zonat e Mbrojtura (Liqenit të Shkodrës, Lumi Buna dhe Rezervat-Velipoje)

#### **V.4.1.Task Forca Vendore Antikanabis**

Në zbatim të Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020 (Miratuar me VKM Nr. 248, datë 29.03.2017, ndryshuar me VKM Nr. 313, datë 31.05.2018), me përfaqësues të Degëve Territoriale të të gjitha Institucioneve që janë të përfaqësuara në TFQ, si dhe përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit) është ngritur Task Forca Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”, është ngritur nga Prefekti i Qarkut (Urdhër Nr. 15, datë 10.04.2017 dhe Nr. 36, datë 03.04.2018)

Nga ana e Prefektit, në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive, në cilësinë edhe të drejtuesit të Task Forcës Vendore janë organizuar 4 takime të Task Forcës Vendore (13.03; 05.04; 07.05 dhe 11.10), takime në të cilat kanë marrë pjesë drejtues të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, ku janë analizuar puna dhe arritjet sipas institucioneve dhe njësive dhe në nivel qarku, dhënë rkomandimet përkatëse:

- Të intensifikohet puna nga të gjitha institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me sensibilizimin e opinionit publik për ndërgjegjësimin e grupeve apo individëve për të mos

ushtruar veprimtari të kundërligjshme të kultivimit dhe tregtimit të bimëve narkotike, duke shtuar edhe qasjen parandaluese në ushtrimin e kësaj veprimtarie të kundërligjshme

- Të rritet niveli i bashkëpunimit në mes të të gjitha institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e planit të masave, të përcaktuara nga vetë këto institucione e njësi, në kuadër të planit të veprimit antikanabis 2017-2020

- Të përmirësohet komunikimi institucional dhe shkëmbimi i informacionit në mes institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, për realizimin e detyrave të përcaktuara në planet e tyre operacionale, në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020

- Të merren masa për plotësimin e nevojave të strukturave të policisë vendore (në mënyrë të veçantë të Komisarariatit të Policisë Pukë), për mjete transporti, për transportimin e grupeve të punës dhe efektivëve të policisë, për kontrollin e territorit

- Për rastet e konstatimit dhe evidentimit të bimëve narkotike për punonjësit, sipas strukturave dhe veprimtarisë që ushtrojnë, përveç referimit të rasteve në prokurori për veprën penale “Shpërdorim detyre” dhe “Moskallzim krimi”(parashikuar nga Kodi Penal, neni 248, 300) nga ana e Institucioneve dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të merren masa disiplinore e largimit të tyre nga puna.

Nga Prefekti i qarkut në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, janë organizuar takime në të 5 bashkitë e qarkut (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Puke dhe Fushë Arëz), lidhur me marrjen e masave antikanabis, takime në të cilat është kërkuar rritja e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrimeve ligjore antikanabis.

Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Prezencës në Shqipëri të OSCE nga ana e Prefektit janë organizuar takime me komunitetin e bashkisë Pukë e Fushë-Arrëz dhe Malësi e Madhe (30 Maj dhe 12 Qershor), në të cilin kanë marrë pjesë drejtuesit e Institucioneve Vendore, të njësive të vetëqeverisjes vendore—përfshi administrator të Nj. A, kryetar fshattrash dhe banor të këtyre njësive, përfaqësues të MB (Drejtori i Drejtorisë për Çështjet Vendore dhe Funkcionet e Deleguara), lidhur me masat ndërgjegjësuese në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike




Nga ana e strukturave të policisë në qarkun Shkodër janë zhvilluar 53 takime sensibilizuese, në të cilat kanë marrë pjesë 2147 persona, të cilat kanë patur qëllim ndërgjegjësimin e publikut në parandalimin e kultivimit të kanabisit

Nga ana e Institucioneve të përfshira në planin e veprimit janë hartuar planet e tyre të veprimit, për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në planin e veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020

Krahasuar me vitin e kaluar 2017, si rezultat i sensibilizimit, ndërgjegjësimin, bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimtarisë në mes të të gjitha institucioneve të përfshira në Task Forcën Vendore dhe me Njësitë e vetëqeverisjes Vendore (bashkëpunim i cili gjatë vitit ka qenë shumë i mirë), për realizimin e detyrave të përcaktuara në planet operacionale të tyre, në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020, është zvogëluar numri i parcelave 31, i rasteve 14 dhe numri i bimëve të kanabisit të kultivuara 12034 rrënjë (nga 119 parcela, 59 raste dhe 15875 rrënjë/fidan/kubik/bimë të

kultivuara dhe të asgjësuara në 88 parcela, në 45 raste me 3841 fidan/kubik/bimë të kultivuara). Gjatë vitit janë proceduar penalisht 49 autorë (8 janë arrestuar në flagrancë, 25 janë shpallur në kërkim, ndërsa 16 ndiqen në gjendje të lirë), nga të cilët 4 kryetar fshati dhe 1 specialist ujësjellësi, për veprën penale “Shpërdorim detyre” dhe “Moskallëzim krimi”. Gjatë vitit është rritur edhe forca goditëse, çka shihet në rritjen masës së zbulueshmërisë së autorëve me 11.4 % krahasuar me vitin e kaluar (nga 57.6 % në 69 %)

*Paraqitja grafike e rasteve, parcelave dhe bimëve narkotike të gjetura dhe të asgjësuar gjatë viteve 2016-2018*



Gjatë vitit, në realizimin e detyrave të përcaktuara, në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, janë konstatuar problematika, të cilat ndikojnë dhe vështirësojnë punën:

- Monitorimi i territorit, në mënyrë të veçantë i zonave të thella malore (zona në të cilat janë pyllëzuara me pemë e shkurre të dendura, ku hasen vështirësi në depërtimin e grupeve të punës dhe për rrjedhojë kontrollin e territorit), të përcaktuara si zona me risk të lartë në kultivimin e bimëve narkotike dhe konkretisht në Njësitë Administrative Shalë, Shosh, Pult të bashkisë Shkodër; Shllak e Temal të bashkisë Vau i Dejës; Shkrel, Kelmend e Kastrat të bashkisë Malësi e Madhe; Gjeggjan e Luf të bashkisë Pukë; Qafë-Mali e Iballë të

bashkisë Fushë Arrëz, monitorim i cili duhet të kryhet nga ajri

- Mungesa e automjeteve me kalueshmëri të lartë pranë DVP Shkodër, për plotësimin e nevojave në transportin e efektivave të policisë në zonat e vështira malore (Për Komisaratin e Policisë Shkodër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Pukë), për të cilat kërkohet plotësimi i nevojave për keto mjete

- *Paisja e DVP Shkodër me 2 dronë*, të cilët të përdoren me qëllim monitorimin/kontrollin e territorit sidomos në zonët e thella malore, ku është e vështirë lëvizja e mjeteve dhe forcave.

#### **V.4.2. Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave**

Është hartuar e miratuar plani i veprimit të luftës kundër trafikimit të personave për vitin 2018, për qarkun Shkodër (plan i cili u është dërguar anëtarëve të Komitetit Rajonal dhe Zevëndësministrit të brendshëm/Koordinatorit Kombëtar)

Janë zhvilluar Mbledhjet e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (I krijuar me Urdhër Nr. 6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo Qark”), ku është trajtuar hartimi i planit kombëtar të veprimit të luftës kundër trafikimit të personave 2018-2020, mbi aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit, kryesisht në pjesën e parandalimit dhe koordinimit, ku Komiteti Rajonal ka fushën kryesore të veprimtarisë së tij, si dhe problemet e veprimtarisë së luftës kundër trafikimit të personave, përfshirë edhe çështjet dhe rekomandimet e tryezës teknike.

Janë zhvilluar takimet e tryezës teknike (të ngritur me Urdhër Nr. 11, datë 24.03.2017, të Prefektit/Kryetarit të Komitetit Rajonal), me përfaqësuesit e institucioneve/anëtarëve të komitetit rajonal dhe shoqërisë civile, në të cilin është rekomanduar që të kërkohet nga anëtarët e Komitetit: Rritja e nivelit të bashkëpunimit të gjitha institucioneve në luftën kundër antrafikimit të personave, në mënyrë të veçantë informimi nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, lidhur me nxënësit që nuk vazhdojnë arsimin, kanë ndërprerë shkollën, nuk frekuentojnë rregullisht shkollën; Organizimi i trajnimit të punonjësve mësimor, veçanërisht i psikologëve të shkollave, lidhur me çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Mundësimi i ndërtimit të 1 qendre rezidenciale për qarkun, brenda territorit të bashkisë Shkodër, në të cilën është përqendruar rreth 61 % e popullsisë së qarkut (Me fondet e buxhetit të shteti, të njëjstive të vetëqeverisjes vendore, me fondet nga donator, etj) për pritjen dhe akomodimin e personave Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit dhe probleme të tjera të veprimtarisë antitrafikim.

Mbështetur në programin e miratuar, gjatë muajit Tetor (i nominuar si muaji i luftës kundër trafikimit të personave) me sloganin *#Bashkë Mundemi! #Luftojmë Trafikimin!* Në qark nga Komiteti Rajonal dhe institucionet rajonale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore-pjesë e Komitetit Rajonal, janë zhvilluar:

- mbi 80 aktivitete ndërgjegjësuese (përfshi takimet e organizuara nga DAR, Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria e Formimit Profesional, Policia Vendore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore; Shoqatat e ndryshme, etj.);

- 22 trajnime, workshope dhe tryeza të rrumbullakëta;
- ekspozita me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, ne te gjitha shkollat e qytetit dhe punimet me te mira për një tre ditë janë prezantuar ne hollin e ndërtesës se Këshillit te Qarkut dhe Institucionit të Prefektit;
- Pjesëmarrja ne ekspozitën Kombëtare ku Qarku Shkodër është prezantuar me 20 punimet me te mira të nxënësve te shkollave te qarkut, me teme luftën kundër trafikimit te personave;
- 3 emisione televizive në mediat lokale;
- 2 Kros, aktivitet sportiv, marshim sensibilizuese në rrugët e qytetit Shkodër e Koplík;
- mbi 22 sesione informuese me komunitetin, nxënës, mësues, psikologë, etj.

Gjate vitit, kanë vazhduar të marrin shërbime rehabilitimi në Qendrën Kombëtare 2 përfitues VT/VMT (1 VT dhe 1 VMT)

Janë identifikuar 3 raste VMT, nga të cilët 1 rast në bashkinë Malësi e Madhe, i cili ka refuzuar të përfitojë nga programet e mbrojtjes sociale, por është në monitorim nga bashkia; Një i ri i komunitetit egjiptian i moshës 16-17 vjeç është dërguar në Qendrën e Rehabilitimit Linëz, nga bashkia Shkodër dhe trajtohet në këtë qendër; Si dhe 1 rast punëkërkues i papunë femër (rast që monitorohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit)

Nga shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit janë kapur 2192 persona në kufi, nga vendet në konflikt (Siri, Irak, Pakistan, Afganistan, Palestinë, Marok, Libi, Algjeri, etj.), nga të cilët 103 të mitur, 56 femra. Janë dërguar e ridërguar në qendrën e azilkërkuesve 2167 shtetas, në qendrën e mbyllur për të huaj 12 shtetas. Ndërsa 13 shtetas janë larguar vullnetarisht. Në pikat e kalimit kufitar janë kthyer 63 shtetas shqiptar-Deportiv. Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të SHSSH Shkodër dhe njësinë e mbrojtjes së minorenëve të bashkisë Shkodër, si dhe me Caritas Shqiptar, janë marrë masa për trajtimin me ushqim, veshmbathje, apo edhe strehim të përkohshëm të personave në nevojë, shtetas të huaj të ardhur nga vendet e treta. Në Spitalin rajonal Shkodër janë dërguar dhe është dhënë ndihmë mjekësore në 20 raste. Gjatë vitit vihet re një tendencë në rritje e fluksit të lëvizjes emigratore nga vendet në konflikt me destinacion vendet e Evropës Perëndimore, të cilët e përdorin vendin tonë si pikë tranziti. Është bërë goditja e elementëve të konstatuar në kushtet e veprës penale *“Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit”* në 15 raste. Ju është refuzuar dalja nepërmjet PKK 1056 shtetasve shqiptar, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, për të udhëtuar apo kanë shkelur rregullat e hyrjes e qëndrimit në vendet e BE. Gjatë vitit vihet re një tendencë në ulje (nga muaji në muaj) për dalje nga vendi i shtetasve shqiptar, kryesisht i moshave të reja, me qëllim për të qëndruar në vendet e Europës Perëndimore, nepërmjet kërkeses për azil, kjo falë edhe forcimit të masave dhe kontrollit të nga shërbimet e policisë kufitare

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror janë 39 vlerësime social-ekonomike të minorenëve që ndodhen të pashoqëruar në emigracion

Janë trajtuar me ndihmë ekonomike 4705 familjeve në qark, nga të cilat: 667 familje me k/familjar e gra dhe gra të divorcuara, 61 familje të komunitetit rom dhe egjiptian, 6 familje me jetim (mbi moshën 25 vjeç), 41 familje me shërbim kujdestarie (përfshi dy fëmijë me PAK). Nga skema e ndihmës ekonomike trajtohen 20 viktima të dhunës

Kanë përfituar nga skema e PAK 5662 persona në qark dhe kujdestari 1620 persona

Në shkollat e arsimit parauniversitar, për periudhën Janar-Qershor (që i përket vitit të shkuar arsimor 2017-2018) nuk janë regjistruar 35 të komunitetit rom; është braktisur mësimi nga 29 nxënës, nga të cilët 9 i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian

Janë identifikuar dhe evidentuar nga bashkia Shkodër 100 raste të fëmijëve të rrugës, për të cilat së bashku me 40 familje janë: Hartuar planet e ndërhyrjes për integrimin; Mbështetur me ndihma ushqimore, veshmbathje e medikamente për fëmijët, të cilët kanë patur probleme shëndetësore; Mbështetur nga ana psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedurat administrative, punësim, ndihmë ekonomike, etj.

Numri i punëkërkuesve të papunë ka qenë gjithsej 5329 (femra 3100), nga të cilët të komunitetit rom dhe egjiptian 219, jetim 6, emigrant të kthyer 58 dhe persona të trafikuar nga punëkërkuesit e papunë 1

Trafikimi i personave, ka patur rënie të treguesve të evidentimit, e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit të Komitetit Rajonal Antitrafik, strukturave të policisë së shtetit, njësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit.

#### **V.6. Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat**

Mbi bazën e planit vjetor të miratuar, në të cilin janë parashikuar dhe planifikuar të gjitha detyrat e sektorit, të shtrira sipas muajve por edhe sipas specifikave të emergjencave të pritshme që e karakterizojnë territorin e Qarkut Shkodër, bazuar edhe në përvojën e krijuar në vitet e shkuara, të cilat kanë qenë

- Izolimi nga Dëbora (Janar 2018)
- Përmytjet (Janar-Mars 2018)
- Shkarjet e dherave, 7 Shtepi në Fshatin Dardhe të Nj.A Blerim në Bashkinë Fushë Arrëz
- Zjarret në Pyje dhe Kullota (Periudha 15 Shtator-15 Nendor)

Për menaxhimin e të cilave, janë marrë masat;

- **Përgatitja dhe abdetimi i planeve të përballimit të Emergjencave**, gadishmerise për secilen skenar të llojit të fatkeqësisë në nivel Prefekturë, si dhe ndjekja për Hartimin e planeve në nivel bashkie.

- Planifikimi dhe Organizimi i sistemit të bashkëpunimit të strukturave në terren, ndertimi i Skemave të organizimit të lajmerimit të hershem, vrojtimit, organizimi operacioneve.

- Përgatitja dhe organizimi i takimeve të KECQ, pothuajse çdo muaj sipas llojit të emergjences dhe çdo dite në situatë emergjente (Janar, Shkurt, për dëboren dhe përmytjen, dhe Maj, Qershor për masat planifikuese për zjarret. (Janë organizuar mbi 60 mbledhje të KECQ, mbi bazën e Rregullores së funksionimit të brëndshëm të KECQ e cila është hartuar për këtë qellim)

##### **a. Emergjencat dimërore (23-26 Shkurt 2018)**

U krijuan problem kryesisht në zonat malore në bashkitë Shkodër, Vau Dejës, Pukë, Fushe Arrëz, Malësi e Madhe, ku për shkak të temperaturave të ulta deri -7 gradë dhe ngricave, u krijuan veshitirësi komunikmi nga Bashkitë me NJA dhe me fshatrat

**Emergjenca e Përmytjes**, menjëherë pas shkrirjes së dëborës, filluan reshjet e shiut të cilat krijuan përmytjet në ultësirën e Nenshkodrës, duke krijuar situatën e mëposhteme: Sipërfaqja totale e përmytur në Qarkun e Shkodrës është 6804 ha Tokë; Shtepi të izoluar nga uji 734 ne dy bashkite

- **Në Bashkinë Shkodër**, u përmyten rreth 155 shtëpi, ku 59 shtëpi ju shkaktuan dëme ne orendi; U evakuann rreth 140 banorë dhe rreth 4079 bageti; U trajtuan me rregjim stallor 637 krerë gjedhë; 2000 krerë të imta; 100 krerë derra; Kulturat bujqësore të përmytura gjithsej 390 ha jonxhë; 255 ha foragjere; 0.7 ha grurë; 2 ha sera; 1 ha vreshtë, 10.2 ha bimë dekorative; 1037 ha livadhe.

- **Në Bashkinë Vau-Dejës**, NJA Bushat, Shtëpi te përmytura 100, shtëpi te rrethuara nga uji 180, banorë të evakuuar 58, toke e përmytur, rreth 1910 Ha.

#### VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE;

##### 1. Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave

MM, DPEC dhe RMSH, ka siguruar mbështetjen maksimale të strukturave njerëzore dhe logjistike nëpërmjet operacioneve të organizuara edhe nga strukturat si DVP, Rep. Usht Vau Dejës, FNSH Shkodër, për evakuim/shpetimin dhe transportin për të gjithë banorët e izoluar nga uji me mjete të transportit rrugor dhe varka gjatë gjithë periudhës së përmytjes. Kanë montuar rreth 330 m barriera kundër përmytjeve në fshatin Shirq, Nj.A. Dajç, si dhe kanë plotësuar të gjitha kërkesat e bashkive Shkodër dhe Vau Dejës në bashkëpunim me DBU, duke plotësuar pothuajse të gjitha nevojat me pako ushqimore për komunitetin dhe bazë ushqimore për bagëtinë, blegtorinë në të gjithë territorin e përmytjes.

Miremenaxhimi i ndihmave ushqimore për komunitetin të ardhura nga Qeveria Shqiptare është bërë konform procedurave ligjore, për këtë si nga ana e Institucionit të Prefektit ashtu edhe nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Vau Dejës u krijuan grupet përkatëse të cilët kordinuan mësimin procesin e transportit dhe shpërndarjes deri tek familjari më i fundit mbi bazën e listave paraprakë të hartuara me përgjegjësi nga KECQ dhe KEC në bashkitë Shkodër dhe Vau Dejës, të cilat u shpërndanë në cdo familje duke tejkuluar nevojat jo vetëm imediate për ushqimë për komunitetin por edhe me baze ushqimore për bagëtinë.

##### 2. Institucionit të Prefektit në rolin e Kryetarit të KECQ për menaxhimin e situatës:

Komisioni i EC në nivel Qarku i drejtuar nga Prefekti, ka funksionuar çdo ditë, ka nxjerrë 30 urdhëra të KECQ dhe janë bërë rreth 60 mbledhje të KECQ për periudhën 1 muaj të kohëzgjatjes së përmytjes të cilët kanë normuar të gjithë veprimtarinë e strukturave në operacionet e evakuimit, transportit, dhënies së ndihmave dhe riparimit të defekteve të OSHE nga ekipet e shpëtimit. Janë bërë cdo ditë inspektime në terren në të gjitha zonat e përmytura për të parë nga afër veprimtarinë e strukturave mbështetëse dhe operacionale për tju gjendur pranë të gjithë komunitetit në nevojë.

**3. Këshilli i Qarkut Shkodër,** Ka akorduar 1,3 milionë lekë të reja në mbështetje të bashkive.

**4. Kujdesi shëndetësor,** Nga DSHP, ISKSH, DS mbi bazën e planeve të hartuara nga ana e tyre u bashkëpunua intensivisht me KECQ dhe të Bashkive dhe me grupet të specializuara mjekësh të mbështetura nga strukturat e specializuara të FNSH, Rep.Vau Dejës, ka mbuluar të gjithë NJA të përmbytura për kontrollin shëndetësor në çdo shtëpi dhe transportin e të sëmurëve për QS Shkodër.

**5. Rendi Siguria.** Nga DVP me rreth 150 Forca me 4 mjete ka monitoruar të gjithë territorin e zonës së përmbytjes duke garantuar rendin e sigurinë publike në të gjithë zonën e përmbytur e sidomos ruajtjen e veprave ujore e ato të rëndësise së veçantë. **Vlen të theksohet se gjatë periudhës një mujore të përmbytjes nuk kemi patur asnjë rast të cenimit të rendit dhe sigurisë publike.**

**6. Rep.Usht.Vau Dejes,** Task-forca e blk-së me të gjithë potencialin organik njerëzor dhe logjistik është angazhuar dhe ka kryer operacione për evakuim banorve, gjësë së gjallë, transportimin, shkarkimin e ndihmave, largimin e ujit nga banesat dhe objektet e rëndësishme si dhe përforcimin e argjinaturave përgjatë lumit Buna me thaës me rërë.

**7. Monitorimi, inspektimi.** Nga ana e Kryetarit të KECQ, drejtuesve të tjerë të institucioneve anëtare të KEC dhe specialistë të fushave është bërë dy deri në tre herë në ditë inspektim i zonës për të konstatuar veprimtarinë e strukturave dhe fikasitetin e tyre në terren.

8. Mund të konkludojmë se pamvarësisht situatës së vështire, situata e përmbytjes u menaxhua me sukses, duke ulur ndjeshem nevojat imediatë të komunitetit, duke ju përgjigjur në kohe emergjencave shëndetësore dhe mbi të gjitha duke garantuar jetën e komunitetit. Edhe në këtë emergjencë që përsa i përket skenarit ishte e ngjashme me atë të vitit 2010, nuk patëm humbje të jetës njerëzore, ngordhje bagëtie dhe asnjë dëmtim të pasurisë shtetërore, vetëm dëme orendishë familjare.

**9. Masat e DSHP, strukturat e DSHP** me mbështetjen e strukturave të Ushtirsë nëpërmjet transporti ujqor ka bërë të mundur kontrollin mjekësor të përditshem të gjithë zonave të përmbytura, duke dhënë precedencë kryesisht të sëmurëve kronikë. Falë ndërhyrjes dhe eficencës së këtyre strukturave u kurorëzuan me sukses të gjitha emergjencat shëndetësore dhe u parandaluan shumë sëmundje të mundëshme duke garantuar jetën dhe shëndetin e të gjithë komuniteti të zonës së përmbytur.Në fazën e rehabilitimit dhe kthimit në normalitet, DSHP është angazhuar intensivisht në procesin e dezinfektimit, duke vlerësuar monitorimin e ujit të pijshëm në zonat e përmbytura dhe me gjërë.

**10. FNSH,** ka vënë ne dispozicion rreth **15 ml barrier 90 punonjes policie, 2 kamione tip IVEKO, 1 kamion** vetshkarkues dhe **1 mikrobuz** tip IVEKO për nstalimin e rreth 330 ml barriera per parandalimin e depertimit te ujit, NJA Dajç, fshati Pentar, parandalimin e permytjes së koloktoveve, duke vendosur thase me rere, evakuim i gjese se gjalle, si dhe. ruajtjen dhe sigurimin e argjinaturave.

**11. Bashkia Vau Dejës.** Ka planifikuar forcat dhe mjetet të mjaftueshme për përballimin e kësaj përmbytje, ka organizuar operacione dhe bashkëpunimin me strukturat e tjera në nivel Qarku dhe ato të mbështetjes të ardhura nga MM.Ka patur një menaxhim të mirë të situatës në fazën e paralajmërimit të hershëm, pasi ju është dhënë mundësia për reagim në kohë



strukturave dhe komunitetit të zonës së përmytur, duke eliminuar pasojat për jetën e banorëve dhe gjësë së gjallë.

**12. DBU, ka** patur një kordinim e bashkëpunim të mirë midis anëtarve të KECQ e institucioneve lokale për menaxhimin e ndihmavë ushqimore për bagëtinë në periudhen e përmytjes. Kordinoi shperndarjen e 425 ton koncentratë dhe 70 ton barë i thatë, duke shpenzuar fondin prej 20 milion lekë i cili ishte I pamjaftueshëm për të përballuar situata të ngjashme për plotësimin e nevojave me koncentratë për blegtorinë, prandaj nga kjo Drejtori kërkohet një planifikim më I mirë financiar dhe real në bashkëpunim me bashkitë për të planifikuar qoftë buxhet financiar dhe të ushqimit për gjënë e gjallë.

**13. Drejtoria e Spitaleve.** Nga ana e Spitalit Rajonal Shkoder jane vene ne gadishmeri mjeket e specialiteteve te ndryshme pjese e grupit te punes te ngritur per kete qellim, si dhe 30 shtreter sipas sherbimeve per nevojat e ndryshme.( 8 ne Kirurgji, 8 ne Patologji, 4 në Infektiv, 4 në Neurologji, 4 në Sanatorium dhe 2 në Reanimacion). Ne sherbimin e urgjences pervec stafit mjekesor ne sherbim eshte mbajtur edhe nje staf tjetër ne gadishmeri per cdo situatë emergjence.

#### **14. Veprimtaria dhe roli i Bashkisë Shkodër:**

- Nga Bashkia Shkodër u morën masat e duhura për kontrollin, monitorimin, menaxhimin dhe organizimin e operacioneve për ti ardhur në ndihmë komunitetit të NJA të përmytura, duke bashkëpunuar me efikasitet me të gjitha strukturat mbështetëse ne nivel Qarku.

- Për herë të parë u krijuar Qendra Operacionale në nivel Bashkie e cila mori përsipër organizimin e mbledhjeve të KEC dhe drejtimin dhe menaxhimin e situatës në nivel Bashkie

- Kryetarja e Bashkisë ka këmbëngulur dhe insistuar në vazhdimësi në shpalljen e gjëndjes së emergjencës pjesore.

#### **b. Emergjencat Verore, Zjarret në Pyje dhe Kullota.**

Specifikë e ketij viti ka qenë sepse zjarret me intensitet kanë filluar në 15 Shtator - 15 Nendor ndryshe nga vite të tjera ku intesniteti i zjarreve ka qenë në periudhen Korrik-Gusht. Periudha Shtator-Nendor, pothuajse të gjitha territoret e bashkive të Qarkut Shkodër janë përfshirë nga situatat e shpeshta të zjarreve masive që përfshinë pyje, kullota, plantacione me pemëtari, bimë etero- vajore, vreshta, bazë ushqimore për bagëtinë, si dhe toka bujqësore me prodhime të stinës, ullishte, masive pyjore bashkiake dhe shtetërore. (Statistikat e zjarreve...zyra Monitorimit).

#### **c. Disa nga Problematikat, që janë konstatuar gjatë vitit 2018 dhe disa Propozime, Rekomandime dhe Detyra në mirëmenaxhimin e situatave emergjente të pritshme.**

Zbatimin i fazave të emergjencave. si Faza e Alarmit dhe Paralajmerimi i hershem, e Planifikimi dhe Përgatitjes, e Përgjigjes, Reagimit dhe Ndërhyrja dhe Organizimi i operacioneve evakuim shpëtim dhe Faza për Kthimin në Normalitet, dhe Rehabilitimit, kanë qenë në përputhshmeri të plotë me Planin e Përballimit të EC të hartuar nga Sektori dhe me situatën konkrete të gjitha fenomeneve që kanë ndodhur gjatë vitit 2018 në territorin e Qarkut Shkodër.

Për përmbytjet: Nisur edhe nga efektet e ngrohjes globale që tashmë ndikojnë në rritjen e frekuencës së përmbytjeve, intensitetit të tyre dhe specifikës gjeografike (përmbytje më të shpeshta shumë herë brenda vitit dhe në disa rajone), mendojmë se:

- Zbatimi i Rregullores për menaxhimin e digave të hidrocentraleve nga KESH në 3 kaskadat ngelet detyrim dhe domosdoshmeri permanente e zbatimit të saj ne kohe dhe hapesire, duke qene non stop transparent dhe ne informim permanent me te gjithë strukturat te tjera bashkepunuese në nivel Qarku dhe Bashkie, qoftë në fazën e paralajmerimit të hershëm, qoftë gjatë fazave kur vazhdojnë shkarkimet e detyruara.

- **Përsa i përket zbatimit të Urdhërit të përbashkët të disa ministrive nr. 248, datë 28.01.2000 “Për hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave.”** I është kërkuar nga Sektori PECK, pesë bashkitë dhe Drejtoria e Ujrave dhe Kullimit Lezhë, bordet e kullimit, funksionimi dhe vënia në gadishmeri të gjithë sistemit ujësjellës-kanalizimeve të stacioneve të pompimit të hidrovorëve dhe rrjetin e furnizimit me energji elektrike e tyre, mbikqyrjen dhe vlersimin e të gjithë sistemit të argjinaturave në ultësirën e Shkodrës, mirëmbajtja e çdo sistemi kullimi, për të parandaluar përmbytjet. Evidentimi dhe kontrolli i të gjitha digave dhe dambave në juridiksion te HEC Vau Dejës, Koman, Fierzë dhe DRUK, Lezhë, ku është konstatuar se gjatë vitit 2018, janë hartuar Planet e Emergjences dhe skemat e vrojtimit për sigurinë e digave dhe veprave shkarkuese, janë përcaktuar masat qe duhet të merren në rastet e rrezikut të digave dhe marrjes së sinjalit të alarmit dhe evakuimit të komunitetit.

- Inspektimi, Monitorimi. Nga Sektori ne bashkepunim edhe me përgjegjësat e zyrave në Institucionin e Prefektit mbi bazën e Planit të Inspektimit Vjetor me tematikë të vecantë, here pas here është kërkuar informacion për masat parandaluese ne të gjitha zonat e rrishtit te bashkive dhe njëkohesisht kemi bere inspektime konkrete ne terren apo duke evidentuar problematikat dhe përcaktuar nderhyrjet perkatese në këto zona, njëkohesisht kemi kërkuar pergatitjen e projekteve perkatese nga bashkive të cilat i kemi derguar per miratim dhe zbatim prane DPEC. Gjatë inspektimeve kemi konstatuar problemet e mëposhtëme:

- Është domosdoshmeri që projektet aktuale në të gjithë infrastrukturën e ultësirës së Shkodrës të cilët të jenë të mirëstudiuara dhe të bëheshin pjesë e diskutimit paraprak e Institucionit të Prefektit, pasi duhet të merret në konsideratë fenomeni i përmbytjes, kjo u vu re edhe në investimet aktuale që po bëhen në segmentet rrugore Shkodër-Velipoje dhe Shkoder-Dajc, pasi niveli i tabanit të rrugës duhet të ishte shumë më i lartë dhe të parashikoheshin më shumë tombino me dimensione dhe kapacitete që të përballojnë sasinë e ujrave.

- **Menaxhimi i mbetjeve urbane, mirëmenaxhimi i bazeneve, parandalimi i nderhyrjeve të kundraligjeshme ngelet detyrë parësore.** Depozitimi i mbetjeve urbane të cilat janë të shtrira në të gjithë territorin aktual të bashkive, janë një problem tepër shqetësues që inkurajojnë përmbytjet në situatat e reshjeve. Për këtë duhet të merren masat konkrete nga bashkitë për të bërë evidentimin dhe përgatitjen e projekteve konkrete per disiplinimin e tyre.

- **Për Magazinimin, transportin dhe Shperndarjen e Ndhimave ushqimore,** është një masë paraprake e cila kerkon marrjen e masave të hershme dhe garantimin e kontratave

paraprake me organizma brenda dhe jashte vendi per garantimin e bazës ushqimore për bagëtime në zonat e përmytura, por njëkohesisht ngritjen apo krijimin e një strukture të parapërgatitur për menaxhimin dhe shpërndarjen e ndihmave që nga burimi, gjatë transportit deri tek nevojtarit që është komuniteti.

- Planifikimi i hershëm I një fondi paraprak të veçantë për blerjen e bazës ushqimore për blegtorinë (bagëtitë) duhet të bëhet për të eliminuar problemet që u shfaqen në përmytjet e vitit, që shkoi, por njëkohesisht kursejmë gjithë ato forca të ushtrisë që kanë qenë të angazhuara për shpërndarjen e bazës ushqimore.

#### **Për izolimin nga dëborat**

- Rritjen dhe kontrollin e përgjegjesive të kompanive të kontraktuara për mirembajtjen e akseve nacionale me sipërmarrje për normalizimin e ketyre akseve në rastet e ngricave apo izolimit nga dëborat (probleme të kësaj natyre kemi patur gjatë dimrit që shkoi).

- Bllokimi i segmenteve të Qafë Thores dhe atij që lidhe NJA të Postribës, Pultit, Shoshit, Shales, Thethit, është një problem tradicional i përvitshëm. Për të cilën kërkohet zbatimi sa më shpejt i projektit aktual Qafë – Thore-Thethe, por edhe përgatitja dhe zbatimi I projektit alternative të segmentit Prekal-Shosh-Shale-Theth.

**Për Zjarret.** Nga analizat e bëra nga të gjitha institucionet ligjzbatuese gjatë vitit 2018, është arritur në Përfundimin se shumica e zjarreve kanë qenë të qellimshme dhe **në të shumten e rasteve nuk janë nxjerrë shkaqet e vërteta dhe autorët e tyre nga strukturat e specializuara.**

- Sistemi i vrojtimit sinjalizimit gjatë vitit 2018 ka funksionuar mjaftueshëm sepse kemi patur raste të shpeshta dhe mangësi të mos organizimit të vrojtimit, marrjes dhe shkëmbimit të informacionit, organizimit të operacioneve, vonesa në nderhyrje për shuarjen e zjarrit, sic ka raste të shpeshta që informacionin e marrim vetëm nga strukturat e policisë dhe jo nga strukturat përgjegjëse, prandaj në të ardhmen duhet të shtohen pikat e vrojtimit në zonat me rrisht zjarri gjatë periudhës së verës dhe të rritet përgjegjëshmeria e tyre.

- Mungesa e koordinimit midis bashkive fqinjë në veçanti ato bashki që nuk e kanë shërbimin zjarrfikës, prandaj është domosdoshmeri kompletimi i strukturave të MNZSH dhe shërbimit pyjor me resurse njerezore të specializuara dhe të paisur me mjete speciale të zjarrfikëseve, me sistem ndërlidhjeje e automjete zjarrfikëse në përgjithësi që është domosdoshmeri emergjentë për të pesë bashkitë, por veçanërisht për bashkitë Vau Dejës dhe Fushë Arrëz që aktualisht nuk kanë mjete zjarrfikëse.

- Mangësi e operacioneve të ndërhyrjeve për shuarjen e zjarreve ka qenë mosangazhimi dhe mbështetja nga strukturat e emergjencave mjekësore në ndihmë të strukturave operacionale në rast asfiksie në luftë kundër zjarreve.

#### **Propozimet ligjore dhe planifikimi**

- Domosdoshmeria e miratimit të Ligjit të ri Për MCR është imediat për mirëfunksionimin e strukturave në varësi të bashkive dhe ato në nivel qendror me qëllim menaxhimin më eficient të situatave të pritshme në të gjithë territorin e Qarkut i cili do të perfeksionojë dhe hartimin e planeve të emergjencave nga të gjitha nivelet e Bashkive

institucioneve në të gjitha fazat e emergjencës për garantimin e sigurisë së jetës së komunitetit me bazë ushqimore dhe ndihma shëndetësore, vlersimi i dëmeve, masat mbrojtëse, pastrimi kanaleve, kolektorëve, pritave malore dhe hartimi i projekteve për rehabilitimin e sistemit të ujërave, kanalizimeve, argjinaturave, pritave malore, etj..

- Fondi rezerve “deri në 3%,” është tashmë një koncept që keqperdoret nga bashkitë dhe nuk zbatohet, pasi fond i parashikuar deri tani në buxhetet e tyre nga cdo bashki nën këtë klauzolë ka qenë në disa raste abuziv dhe i pa përfillshem për buxhetet aktuale të bashkive, prandaj është domosdoshmeri që ky fond me ligj të parashikohet në mënyrë taksative 4 %, duke mos e theksuar shprehjen ...deri..., me qellim që ti përgjigjet menaxhimit të situatave emergjente.

- VKM. Nr. 965 dt.02.12.2015 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emergjencave civile dhe krizave”....., është ngritur pranë Institucionit të Prefektit Sektori ECK, akoma nuk është plotësuar me specialsitin e dyte, ndërsa ngelet problem shqetësues plotësimi i strukturave të drejtorive dhe sektorëve të EC të bashkive sipas kriterëve e cila ndikon në mbarëvajtjen apo efincencën e punës së këtyre strukturave në menaxhimin e situatave emergjente.

- Funksionimit i strukturat të DAP, në shume raste ka zvarritur procesin e plotësimit të organikave të Sektorit dhe është për të dëshiruar në këtë drejtim.

- Eshte domosdoshmeri krijimi i nje Qendre operacionale në ambientet e Institucionit me të gjithë infrastrukturen logjistike dhe njerezore e cila duhet të behet mbi bazen e një projekti enkas.

- Përsa i përket planifikimit të skenareve të parashikuar në planet e emergjencave dhe përputhja e tyre me situatat aktuale që kemi kaluar gjatë vitit 2018, na rezulton se këto plane kanë qenë të përputhura.

- **Zbatimi i VKM 329.** Gjatë këtij viti janë trajtuar gjithsejt rreth 84 praktika të ardhura nga Bashkitë prej të cilave kemi derguar për procedim të metejshem rreth 16 praktika për zjarret dhe rreth 59 dosje për përmbajtjen të Bashkise Shkodër dhe 7 dosje të Bashkinë Fushë Arrëz për fenomenin e shkarjes në fshatin Dardhe të cilat vazhdojnë të jenë në proces dhe nuk janë zgjidhur akoma deri sot, gjë që përben një fenomen të mprehtë social për rreth 84 familje të Qarkut Shkodër.

- Vazhdon të ngelet problem zbatimi i procedurave si vonesat në kohe, mos plotesimi i dokumentacionit nga strukturat përkatëse të bashkive.

## VI. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Marrëdhëneit e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njesite e veteqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në

mënyrë qoftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nenligjore.

Është bashkëpunuar për ushtrimin e funksioneve të transferuara nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës specifike) për kryerjen e këtyre funksioneve

### **VI.1. Kyerja e funksioneve të transferuara njësite të vetëqeverisjes vendore**

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten specifike) për kryerjen e këtyre funksioneve, për:

#### ***1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin***

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për kryerjen e shërbimit janë rritur me 14,884 mijë lekë, ose 20.3 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 89,309 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 13,393 mijë lekë; Shkoder 35,082 mijë lekë; Vau i Dejës 10,929 mijë lekë; Pukë 13,472 mijë lekë dhe Fushë Arëz 15,833 mijë lekë), ose 88.3 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 11,889 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

#### ***1.2.Rrjetin e rrugëve rurale***

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për Mirëmbajtjen e rrugëve rurale, janë rritur me 558 mijë lekë, ose 1 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me fondet nga transfertat specifike me vlerë 95,605 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 15,293 mijë lekë; Shkoder 20,880 mijë lekë; Vau i Dejës 1,407 mijë lekë; Pukë 35,842 mijë lekë dhe Fushë Arëz 22,183 mijë lekë), ose 81 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 23,059 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

#### ***1.3. Pyjet dhe kullotat publike***

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, janë rritur me 20,049 mijë lekë, ose 83 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 39,488 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 10,786 mijë lekë; Shkoder 6,657 mijë lekë; Vau i Dejës 4,231 mijë lekë; Pukë 8,583 mijë lekë dhe Fushë Arëz 9,231 mijë lekë), ose 82 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 8,790 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

#### ***1.4. Sistemin e ujitjes dhe kullimit***

Gjatë vitit fondet nga transfertat specifike, për kryerjen e shërbimit në sistemin e ujitjes dhe kullimit, janë rritur me 5,220 mijë lekë, ose 10.4 %, krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 77,409 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 12,583 mijë lekë;

Shkoder 33,914 mijë lekë; Vau i Dejës 8,919 mijë lekë; Pukë 9,179 mijë lekë dhe Fushë Arëz 12,814 mijë lekë), ose 81 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 18,649 mijë lekë, e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

#### ***1.5.Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar***

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, për sistemin e arsimit (bazë, mesem dhe konviktet e arsimit parauniversitar), janë rritur me 42,136 mijë lekë, ose 10.6 % krahasuar me vitin e kaluar

Janë kryer shpenzime me vlerë 441,203 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 53,986 mijë lekë; Shkoder 253,981 mijë lekë; Vau i Dejës 39,849 mijë lekë; Pukë 59,384 mijë lekë dhe Fushë Arëz 34,003 mijë lekë), ose 94 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 30,277 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

#### ***1.6.Perkujdesi social***

Gjatë vitit fondet nga transferta specifike, janë programuar fonde mbi 2 herë më shumë krahasuar me vitin e kaluar (duke qenë se janë programuar fonde për Bashkinë V.Dejës)

Janë kryer shpenzime me vlerë 27,825 mijë lekë (Bashkia Shkoder 17,029 mijë lekë dhe Bashkia Vau i dejës 10,796 mijë lekë), ose 71 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 11,503 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2019

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera specifike), përmbledhëse dhe sipas bashkive

### Përmbledhëse

*Në mijë lekë*

Nr.	Bashkia	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh. Famil. e individ		Investime		Shuma	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	M.Madhe	82,308	76,661	15,236	13,054	20,982	16,580	560	174	425	175	119,312	106,641
2	Shkoder	227,398	38,398	38,740	36,301	114,824	92,378	20,229	18,318	0	0	404,350	367,543
3	Vau Dejës	67,148	55,891	10,849	9,407	19,153	10,834		0	6,172	0	103,322	76,132
4	Pukë	71,278	68,884	11,989	11,432	16,624	9,109	197	190	38,322	36,845	138,410	126,460
5	Fushë Arëz	64,137	55,323	10,350	9,315	18,812	15,808	413	392	16,500	13,226	109,612	94,064
	<b>Qarku</b>	<b>512,269</b>	<b>295,157</b>	<b>87,164</b>	<b>79,509</b>	<b>190,395</b>	<b>144,709</b>	<b>21,399</b>	<b>19,074</b>	<b>61,419</b>	<b>50,246</b>	<b>875,006</b>	<b>770,840</b>

### 1. Bashkia Malësi e Madhe

*Në mijë lekë*

Funksioni	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma				
	Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt		
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240		3,219	2,708	527	451	9,922	9,427	63				13,731	12,583
Administrimi i pyjeve	01	04260		8,862	8,319	1,447	1,389	1,452	1,048	98	30			11,658	10,786
Rrugë Rurale	01	04520		10,231	9,709	1,627	1,621	4,530	3,727	100	61	175	175	16,664	15,293
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120		41,829	38,192	6,985	6,378	851	121	88	33			49,754	44,724
Arsimi i mesëm (përfshi konvikt.)	01	09230		7,167	7,109	1,175	1,168	1,312	985			250		9,904	9,262
Shërbimi i MZSh-së	01	10910		11,000	10,624	3,475	2,047	2,915	1,272	211	50			17,601	13,993
<b>Totali</b>				<b>82,308</b>	<b>76,661</b>	<b>15,236</b>	<b>13,054</b>	<b>20,982</b>	<b>16,580</b>	<b>560</b>	<b>174</b>	<b>425</b>	<b>175</b>	<b>119,312</b>	<b>106,641</b>

## 2. Bashkia Shkodër

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ e të brend.		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Menaxhim Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	12,388	8,045	1,987	1,322	26,708	24,380	196	166			41,279	33,914
Administrimi i pyjeve	01	04260	9,131	5,169	1,429	934	457	429	146	124			11,163	6,657
Rrugë rurale	01	04520					29,712	18,732					32,812	20,880
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	138,696	138,631	24,111	23,155			878	878			163,685	162,664
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	40,039	40,039	6,736	6,661	52,153	44,394	305	223			99,233	91,317
Përkujdesi social	01	10430	1,015	326	170	60	875	15	18,267	16,628			20,327	17,029
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	26,188	26,188	4,307	4,168	4,919	4,428	437	299			35,851	35,082
<b>Totali</b>			<b>227,398</b>	<b>38,398</b>	<b>38,740</b>	<b>36,301</b>	<b>114,824</b>	<b>92,378</b>	<b>20,229</b>	<b>18,318</b>			<b>404,350</b>	<b>367,543</b>

## 3. Bashkia Vau i Dejës

Në mijë lekë

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	3,083	1,290	504	288	8,103	7,342			567		12,257	8,919
Administrimi i pyjeve	01	04260	4,439	3,626	732	606	222						5,393	4,231
Rrugë rurale	01	04520	1,213	1,206	203	201					5,605		7,021	1,407
Arsimi bazë (parashkollor)	01	09120	31,285	26,632	5,044	4,448							36,329	31,080
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	1,971	1,807	322	302							2,293	2,109
Arsimi (konviktet)	01	09240	7,449	5,707	1,185	953							8,634	6,660
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	9,335	9,278	1,527	1,549	1,532	101					12,394	10,929
Administrimi i Qend.Sociale	01	10140	8,373	6,345	1,352	1,060	9,296	3,391					19,001	10,796
<b>Totali</b>			<b>67,148</b>	<b>55,891</b>	<b>10,849</b>	<b>9,407</b>	<b>19,153</b>	<b>10,834</b>			<b>6,172</b>		<b>103,322</b>	<b>76,132</b>



#### 4. Bashkia Pukë

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	770	691	112	112	3,040	1,138			7,832	7,238	11,754	9,179
Administrimi i pyjeve	01	04260	7,551	6,908	1,473	1,161	1,043	514					10,067	8,583
Rrugët rurale	01	04520	4,253	4,245	786	705	2,588	1,336			30,216	29,556	37,843	35,842
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	33,665	33,513	5,602	5,568			197	190			39,464	39,271
Arsimi i mesëm (përgjith.)	01	09230	5,752	5,752	1,080	977							6,832	6,729
Arsimi (konvikti Pukë)	01	09240	8,388	7,127	1,202	1,178	6,913	5,28			274	51	16,777	13,384
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	10,899	10,648	1,734	1,731	3,040	1,093					15,673	13,472
<b>Totali</b>			<b>71,278</b>	<b>68,884</b>	<b>11,989</b>	<b>11,432</b>	<b>16,624</b>	<b>9,109</b>	<b>197</b>	<b>190</b>	<b>38,322</b>	<b>36,845</b>	<b>138,410</b>	<b>126,460</b>

#### 5. Bashia Fushë Arëz

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për Buxh.famil. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	01	04240	700	474	134	86	3,703	3,028			12,500	9,226	17,037	12,814
Administrimi i pyjeve	01	04260	7,947	7,253	1,463	1,391	587	587					9,997	9,231
Rrugët rurale	01	04520	11,601	10,572	1,657	1,657	11,066	9,954					24,324	22,183
Arsimi bazë (përfshi parash.)	01	09120	27,812	24,500	4,420	4,063			413	392			32,645	28,955
Arsimi i mesëm	01	09230	4,999	4,325	931	723							5,930	5,048
Shërbimi i MZSh-së	01	10910	11,078	8,199	1,745	1,395	2,856	2,239			4,000	4,000	19,679	15,833
<b>Totali</b>			<b>64,137</b>	<b>55,323</b>	<b>10,350</b>	<b>9,315</b>	<b>18,812</b>	<b>15,808</b>	<b>413</b>	<b>392</b>	<b>16,500</b>	<b>13,226</b>	<b>109,612</b>	<b>94,064</b>

## **VI.2. Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.**

Në mbështetje të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Prefekti i Qarkut gjatë vitit ka vazhduar konsultimin dhe bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, duke kryer edhe verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra prej tyre.

### **Ligjshmëria e akteve normative të miratuara nga organet e njësisive të qeverisjes vendore**

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër (në protokoll-arkivin) gjatë vitit 2018, nga 6 njësi të vetëqeverisjes vendore (5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër), janë depozituar gjithsej 567 akte normative. Në mbështetje të ligjit “Për Prefektin e Qarkut” dhe akteve nënligjore specifike, për 474 akte normative Prefekti ka vlerësuar se kanë përputhshmëri ligjore, referuar funksioneve vendore, ndërsa për 93 prej tyre nuk ka lejuar procedimin e mëtejshëm, duke bërë argumentimin ligjor.

Njësitë edhe gjatë këtij viti janë asistuar me ndihmë juridike verbale apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet e pushtetit vendor në interpretimin e ligjit për ti dhënë rrugë zhvillimit vendor & për të qenë sa më afër qytetarit në respekt të parimit të subsidiaritetit.

Gjatë vitit 2018 Institucioni i Prefektit është ndeshur me vendimmarrje, si buxhetet vendore, të cilat kërkojnë kohën për ti analizuar elementet e tyre buxhetore, pasi në fund të fundit është një dokument me karakter të plotë financiar dhe i rëndësishëm për gjithë territorin e bashkisë.

Vendimeve të miratuara nga organi kolegjal me objekt rishpërndarjen e fondeve buxhetore, si kërkesë e ligjeve financiare është kërkuar respektimi i qartë i qëllimit dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit rigoroz të destinacionit të transfertave specifike, edhe pse jemi ndeshur hera herës me oponencë, veçanërisht në përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë, i cili ka një natyrë të vecantë përdorimi. Vendimeve mbi përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë & emergjencë, i cili sipas ligjit financiar duhet të jetë deri në 3% pjesë e buxheteve vendore, por praktikisht në buxhete miratohen në një përqindje të ulët, edhe pse bashkitë e qarkut Shkodër përballen çdo vit me situata natyrore të vështira. Maksimalisht i është kushtuar vëmendje kritereve të ligjit “Për emergjencat civile” dhe VKM Nr.329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, duke respektuar afatet dhe procedurën.

Sistemi fiskal i bashkive paraqet rëndësi jo të vogël për shqyrtim, për shkas se një vendim fiskal i saktë & në përputhje me ligjin sjell të ardhura të ligjshme për bashkitë nëse përdoren me efektivitet nga vetë bashkitë mënyrat e vjeljes. Për shembull gjatë këtij viti

### **Nga verifikimi në vend i akteve të Këshillave të njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore është konstatuar**

Sipas Urdhërit të Prefektit është kryer procesi i verifikimit në vend, nga i cili ka rezultuar se të gjitha NJQV (sekretari i organit kolegjal-personi përgjegjës) kanë depozituar të gjitha aktet me karakter normativ. Specifikisht KB Malësi e Madhe i është lënë masë e menjëhershme përsëri miratimi i rregullores së këshillit bashkiak, me qëllim detajimin e çështjeve të cilat nuk trajtohen sipas ligjit organik, duke parashikuar edhe funksionimin qartazi të komisioneve të përhershme apo të përkoshme të këshillit bashkiak.

Janë kontrolluar edhe aktet e kryetarëve të bashkive, nëse ka pasur të karakterit normativ të cilat nuk janë depozituar në protokoll arkivin.

Praktika e vjetshme gjatë verifikimit në vend që kishte të bënte me procedurat sipas ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, VKM nr.1353/2008 në bashkinë Pukë & Fushë Arrëz për aktet e kryetarit për dhënie pëlqimin për dhënie në përdorim për llojin pyll/kullotë ka ndryshuar/përmirësuar, duke u respektuar procedura vetëm nga këshilli bashkiak sipas nenit 9/12/c & neni 54/gërma e ligjit nr.139/2015 element jo i njohur fillimisht nga vetë struktura e re e pyjeve, e transferuar.

Është konstatuar se nga organet e bashkisë është përmirësuar puna dhe procesi i verifikimit në vend i ndihmon të gjitha palët për tu unifikuar dhe korrigjuar gabimet qoftë në terminologji, qoftë kur keqinterpretohen kompetencat ligjore, e cila mund të vijë për shkak se jo çdo akt është azhurnuar plotësisht.

Organit kolegjal i është rikujtuar, duke kerkuar zhvillimin e seancave të këshillimit parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.139/2015, pasi rregullorja e KB të nuk janë shprehur në asnjë dispozitë mbi formën/mënyrën e zhvillimit të seancave të këshillimit me publikun, si pasojë i është rekomanduar ose të bëjnë shtesa në rregulloret e KB ose sipas rastit kur kërkohen seanca këshillimi të zbatojnë ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin & konsultimin publik”.

Shpeshere në procesin e verifikimit nuk respektohet afati 3-mujor, kjo edhe për mungesë punonjësi, për një periudhë kohe, por edhe për shkak të ndërprerjes apo pezullimit të procesit, pasi drejtuesit e organeve nuk janë disponibël për shkak të impenjimeve të tyre zyrtare.

#### *Proceset gjyqësore*

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve që i jep ligji “Për Prefektin”, “Për vetëqeverisjen vendore”, gjatë vitit ka qenë pjesë e proceseve gjyqësore si palë paditëse, i paditur apo si person i tretë, të cilat kanë iniciuar nga procesi i verifikimit në vend që nga viti 2016, por vetëm tani u arrit të zhvillohej një seancë gjyqësore, seancë e cila u shty si pasojë e procesit të vetingut ndaj gjyqtarit që kishte çështjen. Procesi ka objekt *Deklarim i pavlefshmërisë i aktit administrativ nr.37 datë 03.07.2017 rishqyrtim i VKB nr.32 datë 25.5.2017*, meqënëse këshilli bashkiak nuk i mori në konsideratë kërkesat e Prefektit, por miratoi të njëjtin vendim, sipas së njëjtës procedurë. Meqënëse Prefekti ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti, të qënurit në këto kushte, iu drejtua gjykatës kompetente

për pavlefshmëri të aktit.

Vazhdon procesi gjyqësor për VKK Gjegjan nr.39 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës me fond prej 486,000 lekë, me nr.663 prot dt 04.06.2015, për VKK Gjegjan nr.40 dt 29.05.2015 “Për përdorim të fondit rezervë dhe kontigjencës në shumën prej 130,000 lekë” me nr.668 prot dt 04.06.2015, VKK Rrape nr.2 dt 25.02.2015 “Për përdorim të fondit rezervë në shumën prej 50,000 lekë për ndihmë emergjente djegie banese të një shtetasi, fshati Rrape, si njësi administrative e bashkisë Pukë, vendime normative me karakter financiar të cilat nuk janë depozituar në Prefekturë për shqyrtim, në të cilin Prefekti është në rolin e palës paditëse.

Në shqyrtimin e akteve normative për 2019 pika referimi do të jenë vetëm parimet e ligjshmërisë; Mbrojtjes së interesit publik; Barazisë dhe proporcionalitetit; Drejtësisë dhe paaanësisë; Bashkëpunimit dhe të përgjegjshmërisë; Efiçiensë së sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit, me qëllim minimizim të paligjshmërisë nga të gjithë subjektet.

### **VI.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor**

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organeve të tyre. Njësitë të vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjor (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve; U është rikujtuar detyrimi i përcaktuar në aktin nënligjor, për marrjen e Vendimeve, të trajtimit të familjeve me ndihme ekonomike, brenda muajit; U është rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë organizuar takime të shumta për: Menaxhimin e mbetjeve; Mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën e rendit dhe qetësisë publike; Përballimin e situatave emergjente; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e garantimit të sigurisë ushqimore; Përmirësimi i shërbimit shëndetësor; Krijimi i kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, përfshi sigurimin e ngrohjes në shkolla; Vlerësimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore; Goditjen e informalitetit në sektorin e ujit të pijshëm

Viti 2019 është vit zgjedhor, proces i cili e ngarkon Prefektin në rolin e koordinatorit, dhe punonjësit ndërlidhës për masat e marra gjatë, para dhe pas procesit zgjedhor të datës 30 qershor 2019. Sipas Udhëzimit të ZV/MB, kryetarëve të bashkive aktualisht i është kërkuar zyrtarisht sipas afateve ligjore respektimi i afateve ligjore duke bërë të mundur realizimin e tyre në kohë, garantimin e transparencës maksimale për qytetarët në hartimin, shpalljen dhe njoftimin e shtetasve, shpalljen e listës paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve dhe njoftimin e zgjedhësve brenda afateve të parashikuara në ligjin nr.10190, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH” i ndryshuar. Janë ndjekur afatet si data 4.12.2018, zyrat e gjendjes

civile në bashki/njësi administrative, duhej të printonin ekstraktin e parë të përbërësve zgjedhore të të gjithë zgjedhësve sipas vendbanimit dhe qendrave të votimit, nën juridiksionin e tyre territorial dhe pasi ky ekstrakt firmoset nga kryetari i bashkisë, publikohet në ambientet e bashkive/njësive administrative/në vende me hyrje të lirë të aksesueshëm për publikun. Do të ndiqen në vazhdimësi respektimi i datave 1.2.2019, 29.3.2019 & 28.4.2019 për printimin e ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë. Një detyrë kryesore e Prefektit në referencë të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, i ndryshuar, nenit 94, është t’i paraqesë KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut për vendet e numërimit të votave që përmbushin kushtet referuar nenit 93 pika 1 & 2 e Kodit Zgjedhor. Brenda datës 26.5.2019, kryetari i bashkisë duhet të miratojë dhe firmosë listën përfundimtare duke e dërguar në të tri formatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor të KZAZ-të përkatëse.

## **VII. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE**

### **VII.1. Verifikimi i titujve të pronësisë mbi token bujqësore**

Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut, ka ushtruar aktivitetin e tij në përmbushje me bazën ligjore dhe nënligjore, rekomandimet e Sekretariatit Teknik dhe detyrimet që pasojnë në funksion të zbatimit të ligjit Nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, VKM Nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përberjen, mënyren e funksionimit dhe detyrat e përgjegjesite e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore”, i ndryshuar, Kodi i procedurave administrative, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nga KV – të kur këtë e kërkojnë individë apo institucione”, Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e krijimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish NB – ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Vendore” miratuar me Vendimin Nr. 1 të Komisionit Qeveritar të Tokës dt. 27.03.2009 si dhe akteve nënligjore të nxjerra për zbatim të ligjit, që janë, VKM Nr. 604, datë 05.09.2012, VKM Nr. 605, datë 05.09.2012 “Për procedurat e njoftimit dhe mënyren e pagesës së detyrimit financiar në rastet e pavlefshmërisë së pjesshme të AMTP-ve, si rezultat i mosrespektimit të normës për frymë të tokës bujqësore”.

Për vitin 2018;

Në bazë të Udhëzimit Nr. 1, datë dt.13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të ish NB dhe zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”, dhe Udhëzimit Nr. 2 datë 13.01.2010 “Për

mënyren e verifikimit dhe shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, kur e kërkojnë individë dhe institucione”, ka shqyrtuar dhe marrë 81 vendime, për shfuqizim të plota, të pjeshme të AMTP, apo pezullim e shtyrje

Nga ana e KV është bashkëpunuar me institucionet dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për praktikat dhe vendimet administrative,

Pezullimi i dosjeve administrative objekt verifikimi nga KV për shkak të vdekjes së mbajtësit të parë të titullit të pronësisë AMTP apo anetareve të familjes bujqësore, në rastet kur mungon deshmia e trashëgimise, kur kjo konfirmohet nga institucionet përgjegjëse, ka qenë një nga problematikat e ndeshura gjatë vitit, duke qenë se KV nuk mund të dalë me vendim përkatës, ndonëse konstatohet paligjshmeria rast pas rasti.

## VII.2. Shërbimet sociale

Me fondet e buxhetit janë trajtuar nga skema e ndihmës ekonomike 4705 familje, ose 4.5 % e numrit të familjeve të qarkut prej 103951 (Në bashkinë Malësi e Madhe 847 familje, Shkoder 1845 familje, Vau i Dejës 1020 familje, Pukë 496 familje dhe Fushë Arrëz 497 familje). Po kështu janë trajtuar nga skema e paaftësisë (Persona me aftësi të kufizuar dhe kujdestar të tyre) 7088 persona, si dhe invalidë të punës 4553 persona

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social ka ushtruar veprimtarinë mbështetur në VKM Nr.512 datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike , pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve sociale”, i ndryshuar, si dhe muaji Tetor 2018 e në vazhdim mbështetur në VKM Nr 566 datë 29.9.2018, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për NE dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e vartësisë së Shërbimit Social Shtetëror dhe pranë njërive të qeverisjes vendore”. Ndjekja e kryerjes së pagesave të ndihmës ekonomike dhe paaftësisë është bërë duke kordinuar nevojat për fonde, realizimin i tyre, nevojat shtesë apo rishpërndarjet midis njërive administrative (Bashkit) të qarkut tonë në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë kryer 24 kontrolle në njësitë administrative të bashkive, brenda territorit të qarkut (Në bashkinë M.Madhe 6, Shkoder 5, Vau i Dejës 3, Pukë 5 dhe Fushë Arrëz 5) nga 33 Nj.A, nga të cilat është ulur numri i përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike dhe PAK (150 persona). Janë kryer 543 verifikime në familje

Nga vlera e dëmit ekonomik, pagesë paaftësie 182110 lekë, gjetje nga kontrollet e kaluara është arkëtuar 21012 lekë (vetëm 2 persona në Nj.A Qender Koplík dhe Nj.A Berdice), ose 11.5 %, duke mbetur pa u arkëtuar 161098 lekë (në të gjitha njësitë e tjera), ndërsa ndihma ekonomike (+6 %) e gjithë shuma prej 312112 lekë, përfituar nga 39 familje nuk është arkëtuar, kjo edhe pasi me fillimin e skemës së re të ndihmës ekonomike nuk u

kontrolluan detyrat e lëna sepse ishte një skemë që ndryshonte në shumë të dhëna.

Nga 24 kontrollet dhe 543 verifikime në familje, kanë rezultuar:

- Nga skema e ndihmës ekonomike, përfitime në shkelje të ligjit 42 familje me vlerë 212,211 lekë ( Në bashkinë Pukë 26 familje me vlerë 99971 lekë; Në bashkinë Fushë Arrëz 16 familje me vlerë 111240 lekë)
- Nga skema e PAK, përfitime të padrejta nga 31 persona me vlerë 638767 lekë (Në bashkinë Malësi e Madhe 16 persona me vlerë 170532 lek; Në bashkinë Shkoder 3 persona me vlerë 61980 lekë; Në bashkinë Pukë 8 persona me vlerë 126760 lekë dhe në bashkinë Fush Arrëz 4 persoan me vlerë 279495 lekë)

Nisur nga gjetjet e konstatuara, për eliminimin e parregullsive dhe arkëtimin e shumave të përfituara padrejtësisht janë lenë 121 rekomandim detyra, nga të cilat janë realizuar 97, ose 80.2 % e tyre

Po kështu ndër problematika e hasura gjatë kontrolleve te ushtruara, duke bërë një analize referuar dinamikës së NE dhe PAK;

- Këshillat e Bashkive nuk marrin vendimin për propozim brenda datës 20 të muajit në disa raste.
- Nuk është plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar dosja e përfituesve të NE. (mungon kopja e vertetimit të KMCAp, dokumentacioni i përfitimit të energjisë elektrike, dokumentacioni i shkollës).
- Llogaritja e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% nuk llogaritet saktë fondi sipas Njësive (Fondi llogaritet në rang Bashkie) dhe trajtohen padrejtësisht disa familje.
- Nuk respektohen afatet e rikomisionimit të dosjeve.
- Nuk plotësohen në afat dosjet me dokumentacionin përkatës.

### **VII.3. Zhvillimi i territorit**

Për zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur problem te ndryshme të territorit si strehimi, pronësie dhe mjedisi. Jane ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara per hartimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë Puke, Fushe Arres dhe Vau-Dejës, veprimtari e cila konsiston ne pjesmarrjen ne disa dëgjesa publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër dhe Malësi e Madhe, për hartimin e planit të përgjithshëm vendor, duke rekomanduar bashkërendimin e punës në të gjitha hapat që do të ndërmerren për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendorë konformë ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zvillimin e teritorit” (bashki të cilat kanë miratuar në këshill bashkiak PPV).

Problemet në lidhje me distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës dhe lartësinë e ndërtesës, moszbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, shqyrtimi i ndërtimeve pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi, në lidhje me pagesën e kështëve për shlyrjen për pëfitimin e programeve sociale të strehimit dhe probleme me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse nga aktivitetet tregtare. Është bërë konfirmimi i gen planeve të objekteve që privatizohen apo jepen me qera,objekte këto sipas Njesive Administrative të bashkive brenda territorit të qarkut.

Është bashkëpunuar me agjensinë e Basenit Drin-Bunë për të gjitha problemet që janë paraqitur duke bërë verifikimin e problemeve sipas rasteve të paraqitura dhe përgatitjen e marrjen e masave për organizimin e mbledhjeve të KBU Drin – Bunë. Puna kryesore ka konsistuar në zbatimin e UKM 228 datë 1.12.2017 të Kryeministrit, duke ngritur grupin vendor të punës dhe për ushtrimin e detyrave të ngarkuara dhe duke ushtruar kontrolle në terren. Grupi i punës u orientua sipas hartave të evidentimit të shfrytëzimit të inerteve për Basenin Drin-Bunë të dërguara nga grupi qendror i punës. Nga verifikimet në terren gjendja, sipas hartave të evidentimit të shfrytëzimit të inerteve, ka rezultuar në 25 raste një stok prej rreth 700,000 m<sup>3</sup>, stok i cili është lënë detyrë të hiqet (detyrë e cila është në zbatim). Po kështu nga verifikimi ka rezultuar:

- Nuk ka raste të shfrytëzimit të paligjshëm të lumenjve dhe shtretërve të tyre (mbase këtu ka ndikuar fakti se në peridhën e ushtrimit të kontrolleve Dhjetor - Qershor, ka pasur nivele të larta të ujit dhe ka qenë dhe kjo një pengesë për marrjen e zhavoreve)
- Të gjitha subjekteve të licensuara iu mbaron leja Brenda muajit Qershor 2018
- Marrja e materialeve inerte në shtretërit e lumenjve në ato zona ku është e nevojshme (sipas projekteve të studiuara) ka pasur ndikim pozitiv në mbrojtjen nga përmytja të zonave pranë lumenjve. Këtë e tregoi rasti i firmës “Sabina dhe DEDI MA” pranë fshatit Beltojë, ku si rezultat i marrjes së zhavorit në zonën e përcaktuar në projekt
- mbrojtja nga përmytja e muajit Mars, fshatrat Kuq e Vukatanë.

Nga ana e Institucionit të Prefektit, nisur nga gjendja e rezultuar, e cila paraqitet në përgjithësi mirë, është kërkuar koordinim i veprimtarisë të të gjitha strukturave shtetërore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, në myrë menyrë të veçantë Inspektoratit Shtetëror për monitorimin e vazhdueshëm të situatës.

**Po kështu nisur nga fakti që lumenjtë Drin dhe Kir çdo vit sjellin me mijëra m<sup>3</sup> materiale inerte, të cilët bllokojnë rrjedhën e ujit duke u bërë shkak për përmytjen e zonave pranë brigjeve (banesa, biznese dhe kultura bujqësore), pas konsultave me specialist të ujërave, rekomandojmë që të hartohet dhe miratohet sa më parë baza ligjore për lejimin e marrjes së materialeve inerte në ato zona ku lumenjtë e kanë të domosdoshme, gjithmonë duke u bazuar në studime e projekte të hartuara nga eksperitë të fushës. Realizimi i këtyre ndërhyrjeve nga njëra ruan rrjedhën normale të lumenjve, duke ulur ndjeshëm rrezikun e përmytjeve, nga ana tjetër, i jepet mundësi sektorit të ndërtimit marrjen e inerteve të cilët janë të domosdoshëm për këtë sektor.**

#### **VII.4. Zhvillimi i turizmit**

*Nisur nga arritjet, viti 2018, ka qenë një vit i suksesshëm në zhvillimin e turizmit në qarkun tonë, arritje të cilat shihen qartazi, në rritjen e numrit të turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qendruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë shtimin e të ardhurave nga turizmi.*

##### **VII.4.a. Objektivat vjetor;**

- Garantimin e rendit dhe qetësisë publike, parandalimin e veprimtarisë kriminale në të gjitha plazhet dhe zonat turistike, nëpërmjet riorganizimit të shërbimeve të policisë në pikat e kontrollit dhe kontrollin e territorit në të gjithë qarkun;



- Ofrimi i shërbimeve të ndihmës së shpejtë dhe zgjidhjes së problemeve për turistët dhe pushuesit, me prioritet në zonat turistike, në çdo rast nevojë, nëpërmjet krijimit të njërive policore të përkohshme dhe të lëvizshme, pranë qendrave dhe zonave turistike;

- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset dhe në rrugët e zonave turistike me përparësi, si dhe parandalimi i aksidenteve automobilistike nëpërmjet kryerjes së shërbimeve të drejtpërdrejta për drejtimin dhe monitorimin e trafikut veçanërisht në zonat turistike;

- Lehtësimi i hyrje-daljeve të shtetasve të huaj dhe vendas në kufi, nëpërmjet ofrimit të shërbimit cilësor dhe të shpejtë, duke shtuar shërbimet e Policisë Kufitare në pikat e kalimit kufitar;

- Përmirësimi i shërbimeve të policisë nëpërmjet rritjes së standardeve në përmbushjen e detyrës, etikës së komunikimit në shërbim, si dhe siguri i paraqitjes dinjitoze dhe komunikimit me qytetarët, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve;

- Krijimi i një mjedisi të pastër për pushuesit;

- Shmangien e informalitetit, goditjen e paligjshmerisë dhe invazionit fiskal në ushtrimin e veprimtarisë biznesit në zonat turistike, si dhe rritjen e të ardhurave nga turizmi; në përgjithësi janë arritur

Megjithë problemet e hasura, sezoni turistik veror 2018, ka qenë sezoni më i mirë, krahasuar me sezonet e viteve të fundit.

Gjatë sezonit është;

- Garantuar siguria publike në zonat turistike (Është ruajtur qetësia dhe rendi, janë parandaluar aktet kriminale, duke mos u evidentuar asnjë ngjarje kriminale; Është mirëmenaxhuar trafiku, duke forcuar sigurinë rrugore; Si rezultat i kontroleve dhe masave të marra ka patur një menaxhim të mirë të mjeteve ujore, duke mos shënuar asnjë problem; Janë marrë masa parandaluese ndaj zhurmave, duke eliminuar ndotjen akustike dhe duke krijuar qetësi tek pushuesit; Ka patur një menaxhim më të mirë dhe përpunim të shpejtë të turistëve dhe mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar)

- Krijuar një mjedis i pastër, nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;

- Rritur numri i turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qëndruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë janë rritur të ardhurat nga turizmi

Progresi në zhvillimin e turizmit ka ardhur nga përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njërive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive për këtë sektor; Kështu,

- Është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendra shëndetësore me personelin e duhur, por duke qëndruar në gatishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike;

- Është përmirësuar infrastruktura rrugore drejt zonave turistike, në mënyrë të veçantë rruga “Shkodër-Velipojë (segmenti Harku i Berdicës- Kryqëzim Baks)”, me investimin e qeverisë (nëpërmjet FSHZH), për rikonstruksionin e plotë të kësaj rruge, me një

vlerë prej 2 297 167 mijë lekë (ndarë në tre lote), ku punimet kanë përfunduar në masën 87.2 % për lotin e I-rë, 75 % dhe 98 % për lotin e II-të dhe të III-të

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të rrugëve janë kryer ndërhyrje për rikonstruksione të pjesshme dhe mirëmbajtja e akseve rrugore me destinacion turizmin;

- Janë marrë masat nga ana e policisë së shtetit për sigurinë publike në zonat turistike, si dhe nga policia e qarkullimit rrugor për parandalimin e aksidenteve gjatë sezonit;

- Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të shpejtë në lëvizjen e shtetasve të huaj e shqiptar (hyrje e dalje) në pikat e kalimit kufitar (Muriqan, Hani i Hotit dhe Bashkim) si dhe për përdorimin e mjeteve motorike lundruese argëtuese (Si rezultat i masave të marra nga shërbimet e policisë kufitare, në stacionet e plazhit, nuk ka patur asnjë incident nga mjetet lundruese argëtuese gjatë sezonit turistik);

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer inspektime dhe kontrole, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore, në plotësimin e kushteve dhe standardeve ushqimore, si dhe mbrojtjes së konsumatorit;

- Nga ana e organeve tatimore janë marrë masa kundër informalitetit, goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike.

- Po kështu ka patur një përmirësim dukshëm të punës së njësive të vetëqeverisjes vendore për pastrimin e territorit në zonat turistike, menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër; Organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore e të traditës; Marrjen e masave për shmangien e ndotjes akustike të gjeneruar nga subjekte dhe veprimtari të ndryshme gjatë sezonit, etj;

- Nga ana e Operatorit të shpërndarjes energjisë elektrike, nëpërmjet masave të marra (investime e mirëmbajtje në rrjetin e TM/TU, në nënstacion e kabina elektrike) është siguruar furnizim pa ndërprerje me energji elektrike gjatë gjithë sezonit;

- Nga ana e Sh. A “Ujësjiellës-Kanalizime” me masat e marra është siguruar një furnizim normal dhe me cilësi me ujë të pijshëm për zonat turistike dhe në mënyrë të veçantë i plazhit Velipojë, ku gjatë gjithë sezonit ka një patur furnizim pandërprerje

- Është rritur numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese (Resort, Hotel, Motel, Bujtinë, etj), për rrjedhojë edhe të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar mbi 50 %. Në plazhin Velipojë, sipas numrit të netë/fjetje, janë akomoduar mesatarisht rreth 2600 pushues në ditë, Në pikën turistike Theth rreth 150 pushues në ditë dhe në qytetin e Shkodrës rreth 240 pushues në ditë; Në pikat turistike të M.Madhe (Razëm, Vermosh e zonën e Kelmendit) rreth 60 pushues në ditë.

- Është rritur numri i turistëve në kalanë e Shkodrës, si një nga monumentet me të vizitueshme në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, duke shënuar një rekord prej mbi 102 000, ose 2 herë më tepër krahasuar me sezonin e vitit të kaluar (ku numri i turistëve ka qenë rreth 48 700)

- Numri i subjekteve private të cilat kanë ushtruar veprimtari biznesi në zonën e

plazhit ka qenë 522 (Subjekte të biznesit të vogël 318 dhe subjekte me TVSh 204)

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer 46 inspektime dhe kontrole, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore, në plotësimin e kushteve dhe standardeve ushqimore, si dhe mbrojtjes së konsumatorit, në përfundim të cilave, për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara (Mungesë e kushteve higjieno sanitare; mungesë të gjurmueshmërisë së ushqimeve; problem me etiketimet e produkteve ushqimore; Mungese etiketash në gjuhën shqipe; Problematika me analizat e ujit; Mungese e planit Dezinfektimi, Derratzimit dhe Dezinfektimit; etj) janë marrë 36 masa administrative (Ndërprerje të aktiviteti 3 raste, gjobë 17 raste me vlerë 2,000 mijë lekë dhe paralajmërim për ndërprerje të aktivitetit 27 raste)

- Nga ana e organeve tatimore për goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike; Kështu janë monitoruar 104 tatimpagues, si dhe janë realizuar 40 vizita fiskale në terren, në përfundim të të cilave janë rritur treguesit e pagesës së TVSh-së rreth 40 %, si dhe janë bërë 5 rivlerësime tatimore me vlerë 614 mijë lekë; Ndërsa nga Hetimi tatimor janë ushtruar 762 kontrole (nga 458 kontrole të kryera gjatë të njëjtës periudhë të sezonit të kaluar), në përfundim të të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara janë marrë masa të ndryshme, penalitete (gjoba, referime në prokurori, etj.) në 239 raste, si dhe janë marrë masat e bllokimit të aktivitetit për 39 subjekte, të pa regjistruara në QKB

- Nga ana e Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë kryer 620 inspektimet në zonat turistike, duke vazhduar edhe inspektimet dhe monitorimet e zbatimit të ligjit anti duhan dhe anti alkool, në përfundim të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara janë marrë 15 masa administrative (nga të cilat 10 për duhanpirje; 2 në fushën e stomatologjisë; 1 për mungesë librezë shëndetësore; 1 mos zbatim detyrash; 1 në subjektet DDD). Po kështu gjatë sezonit janë lëshuar në total 86 Akt Miratime Higjieno Sanitare (për hotele, restorante, bare, pishina, markete, mjete transporti, baxho, piceri,aktivitete të shërbimeve spitalore,farmaci).

- Nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit janë kryer inspektime dhe monitorime, lidhur me menaxhimin e mbetjeve dhe shkarkimin e ujërave të pa trajtuara në 125 subjekte, si dhe ndotjen akustike 9 subjekte, në përfundim të të cilave, janë njoftuar, duke u kërkuar pajisjen me lejen përkatëse mjedisore, sipas kërkesave të ligjit,subjekteve të cilat e kanë detyrim ligjor; Ndërsa subjekteve të cilat gjenerojnë zhurma, me veprimtarinë muzikore, pas matjes së nivelit të këtyre zhurmave, u është këshilluar mbajtjen e nivelit brenda kufijve të lejuar, si dhe respektimin e orarit.

#### **VII.4.b. Problematikat e hasura dhe koordinimi me aktorët e tjerë publik për sa i përket garantimit të sigurisë fizike të pushuesve, cilësinë e shërbimit, shëndetit publik, higjienës etj. të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në mbarëvajtjen e turizmit:**

- Administrimi dhe menaxhimi i territorit dhe hapësirave publike (zënia forcërisht dhe përdorimi i hapësirave publike, sipërfaqe të territorit të plazhit, nga subjekte dhe individë për qëllime biznesi)

- Mos zbatimi i kritereve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet

*dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së plazhit*” (miratuar në VKM 369 datë 18.05.2016), në stacionet e plazhit, lidhur me vendosjen e kullave të vrojtimit gjatë gjithë gjatësisë së plazhit me vrojtues, gjatë gjithë orarit të plazhit (neni 6/3.ç i rregullores)

- Moszbatimi i kriterëve të përcaktuara për krijimin e sigurisë në plazhin Velipojë (Mos mbulimi i të gjithë gjatësisë së plazhit me kulla vrojtimi në distancën e përcaktuar për çdo 200-250 m plazh; Mungesa e vrojtuesve, përfshi edhe stacionet e plazhit publik; Mungesa e pajisjeve me elementët përkatës të kullave të vrojtimit, përfshi pajisjet më elementare)

- Cilësia e ujit të pijshëm të furnizuar nëpërmjet puseve të shpimit në zonën e plazhit Velipojë, por edhe nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit persa i përket parametrave fiziko-kimik (shtim nitrite nga ndotës të përhershëm-stalla bagëtish në zonën përreth stacionit të Ujësjellësit Trush, si dhe precipitim mbetjesh i ujërave të ndotura të kanalit anësor të rrugës Trush-Ura e Gjon Lulit)

#### **VII.4.c. Rekomandime**

• Nisur edhe nga problemet e hasura dhe pamundësia e njësisve të vetëqeverisjes vendore në administrimin e stacioneve të plazhit, për një mirëmenaxhim dhe zhvillim të turizmit, rekomandojmë që stacionet e plazhit të administrohen nga një strukturë e veçantë e krijuar nga qeveria në shkallë vendi

• Plazhi Rrjoll, Nj. A Velipojë të përfshihet në listën e plazheve të miratuara (Shtojca 1 e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, miratuar me VKM Nr. 369, datë 18.05.2016)

#### **VII.5. Shërbimi i gjendjes civile**

Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile ka grumbulluar, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar certifikata përkatëse (sipas kërkesave të shtetasve apo institucioneve të ndryshme), të gjendjes civile, për dokumentacionin që administron vetë zyra, duke u bazuar në rregjistrat themeltarë si dhe në aktet e tjera

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësisve administrative pjesë përbërëse e këtyre bashkive, duke bërë verifikimet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme si Prokuroria, Gjykata, Sigurimet Shoqërore, Drejtoria e Policisë apo Zyra Konsullore.

Është bashkëpunuar me zyrat e Gjendjes Civile të njësisve të vetëqeverisjes vendore

për marrjen e masave në korrigjimin në afat dhe në menyrë korrekte nga punonjësit e ketyre zyrave

Ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore”Për gjendjen Civile” u janë bërë të njohura zyrave të gjendjes civile brenda qarkut.

Aktualisht po ndiqet azhurnimi i sistemit të adresave, me qëllim realizimin e detyrës së dhënë nga MB, për eliminimin e shtetasve pa adresë të përcaktuar (kodet 000, 888, 999) në regjistrin kombëtar të gjendjes civile brenda 25 Shkurtit

## VIII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS

### VIII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër*"), si dhe e Komisionit vendor të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore, sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Ministrave (VKM Nr. 1269 date 17.09.2008 "*Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësive të strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi token bujqësore*"), me ndryshime), me një organikë prej 33 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi e Madhe dhe Pukë)	2
4.	Spektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
5.	Spektori i zhvillimit urban	3
6.	Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	3
7.	Spektori juridik	3
8.	Spektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	7
9.	Komisioni vendor i vlersimit të titujve të pronësisë	6

Në fakt administrata ka funksionuar me 3, 4 dhe 5 punonjës më pak (sipas periudhave të ndryshme gjatë vitit), pasi pozicionet e punës kanë mbetur vakant, për arsye të moskryerjes së procedurave të konkurrimit dhe emërimit të punonjësve në keto pozicione (Aktualisht, sipas strukturës, mbeten akoma vakant 2 pozicione, Spektori i Financës dhe shërbimeve mbështetëse 1; Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave 1)

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 34,324 mijë lekë, ose 91.5 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim fondesh prej 3,193 mijë lekë. Ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 2,931 mijë lekë, ose 99.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 24 mijë lekë.

Programimi dhe përdorimi i fondeve, sipas programeve, në nivel art. Paraqitet, sipas pasqyrës:

Në mijë lekë

Art.	N/Art.	Emertimi i shpenzimeve	Programimi dhe përdorimi				
			Plan 2018	Ndrysh.	Plani me ndrysh.	Fakti	Dif.
<b>Totali i shpenzimeve Administrata e Prefektit dhe Gjendja civile</b>			<b>37,060</b>	<b>3,412</b>	<b>40,472</b>	<b>37,255</b>	<b>3,217</b>

*Adminsitrata e Institucionit (Gr.16, T 1160, Kap. 1)*

<b>600</b>		<b>Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli</b>	<b>21,000</b>	<b>2,000</b>	<b>23,000</b>	<b>22,703</b>	<b>297</b>
<b>601</b>		<b>Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore</b>	<b>5,200</b>	<b>- 1,400</b>	<b>3,800</b>	<b>3,754</b>	<b>46</b>
<b>602</b>		<b>Mallra dhe sherbime te tjera</b>	<b>8,000</b>	<b>-600</b>	<b>7,400</b>	<b>4,923</b>	<b>2,477</b>
	<b>6021</b>	<b>Materiale dhe sherbime zyre te pergjithshme</b>	<b>540</b>	<b>200</b>	<b>740</b>	<b>541</b>	<b>199</b>
	0100	Kancelari e tjera	240	100	340	299	41
	0200	Mat. për pastrim,dizifek.,ngrohje dhe ndriçim	120	-	120	46	74
	0300	Materiale për funksionimin e zyreve	150	50	200	146	54
	0500	Blerje dokumentacioni	10	20	30	-	30
	0900	Furnizim dhe materiale të tjera zyre e të përgjithshme	20	30	50	50	-
	<b>6022</b>	<b>Sherbime nga te tretet</b>	<b>1,830</b>	<b>-</b>	<b>1,830</b>	<b>1,537</b>	<b>293</b>
	2001	Elektricitet	500	-	500	462	38
	2002	Uje	120	120	67	53	
	2003	Sherbime telefonike:	320	-	320	125	195
		<i>Fikse</i>	200	-	200	89	111
		<i>Celulari</i>	120	-	120	36	84
	2004	Sherbime te tjera (Posta)	800	-	800	821	+21
	2010	Sherbime të printimit dhe publikimit	90	-	90	5	85
	<b>6023</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>1,020</b>	<b>160</b>	<b>1,180</b>	<b>1,019</b>	<b>161</b>
	3100	Karburanti	790	-	790	790	-
	3200	Pjese kembimi , goma dhe bateri	140	100	240	117	123
	3300	Rregjistrim,kaludim ,siguracion	80	20	100	100	-
	3900	Te tjera	10	40	50	12	38
	<b>6024</b>	<b>Shpenzime udhetimi</b>	<b>600</b>	<b>-</b>	<b>600</b>	<b>426</b>	<b>174</b>
	4100	Udhetim i brendshem	600	-	600	426	174
	<b>6025</b>	<b>Shpenzime per mirmbajtje te zakonshme</b>	<b>1,710</b>	<b>-700</b>	<b>1,010</b>	<b>371</b>	<b>639</b>
	5600	Shpenzime per mirmbajtjen e mjeteve te transportit	100	-	100	100	-
	5800	Shpenzime per mirmbajtjen e paisjeve te zyreve	790	-	790	171	619
	5300	Shpenzime per mirmbajtjen e objekteve ndertimore	100	-	100	100	-
	5500	Shpenzime për mirëmbajtje aparateve,pajisje e veg punës	720	-700	20	-	20
	<b>6027</b>	<b>Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale</b>	<b>1,390</b>	<b>-</b>	<b>1,390</b>	<b>961</b>	<b>429</b>
	602.74	Shpenzime per vendime gjyqsore për largim nga puna	1,200	-	1,200	961	239
		Shpenzime për detyrime të tjera	190	-	190	-	190
	<b>6029</b>	<b>Shpenzime te tjera operative</b>	<b>210</b>	<b>40</b>	<b>250</b>	<b>58</b>	<b>192</b>
	602.9	Shpenzime per pritje percjellje	10	40	50	-	50
	602.91	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime	100	-	100	17	83
	602.9	Shpenzime per tatime,taksa,rregjistrim pasurie nga inatit. etj.	100	-	100	41	59
<b>606</b>		<b>Transferta per buxhete familjare dhe individe</b>	<b>-</b>	<b>317</b>	<b>317</b>	<b>317</b>	
<b>230</b>		<b>Shpenzime per rritje te A.Q. te patrupsuara</b>	<b>-</b>	<b>3,000</b>	<b>3,000</b>	<b>2,628</b>	<b>332</b>

231	Shpenzime per rritjen e A.Q. Te trupzuara	-	-	-	-	-
	<b>Shuma:</b>	<b>34,200</b>	<b>3,317</b>	<b>37,517</b>	<b>34,324</b>	<b>3,193</b>

**Gjendja Civile (Gr.16, T 1170, Kap. 1)**

600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenz. personeli	2,450	70	2,520	2,502	18
601	Kontribut per sigurime shoqerore dhe shendetesore	410	25	435	429	6
602	Mallra dhe sherbime te tjera					
	<b>Shuma</b>	<b>2,860</b>	<b>95</b>	<b>2,955</b>	<b>2,931</b>	<b>24</b>

**VIII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre**

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga Prefekti janë nxjerrë 70 Urdhra, me problematika të ndyshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara

Administrata ka zbatuar në të gjitha rastet urdhërat e nxjerrë, duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

**VIII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë**

**Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”**

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësi nga ana e Prefektit janë zhvilluar mbi 100 takime, përfshirë edhe takimet e grupit këshillues pranë Prefektit (sipas fushave dhe sektorëve të veprimtarisë), takime të cilat në formë të përmbledhur, sipas çështjeve të trajtuara, paraqiten:

- Mbi problematikat në kuader të luftës kunder kultivimit të bimeve narkotike, zbatimi i planit të veprimit antikanabis 2017-2020 (Takime periodike të Task Forcës Vendore Antikanabis, datë 13 Mars, 7 Maj, 11 Tetor; Në bashkëpunim dhe mbështetje të Prezencës në Shqipëri të OSCE, Takime me komunitetin e bashkive Pukë e Fushë Arrëz datë 30 Maj dhe të Malësisë Madhe datë 12 Qershor; Takim me përfaqësues të Prezencës në Shqipëri të OSCE datë 5 Prill; Takime me drejtues të institucionet rajonale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në të cilat vazhdimisht janë trajtuar problemet e luftës ndaj kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike)

- Mbi çështjet e luftës kundër trafikimit të personave (Takime periodike të Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave dhe të Tryezës Teknike, takime të Prefektit me delegacionin Anglez datë 8 Shkurt; Takim datë 22 Qershor i KRLKTP në bashkëpunim me MB; si dhe takime gjatë muajit Tetor-muaji antitrafik)

- Mbi menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër, kostimin e shërbimit; pastrimin e brigjeve të lumenjve, liqenit dhe bregdetit (Takim datë 7 Shkurt, Takim 11 Prill; Takime në Maj e Qershor dhe Dhjetor)

- Mbi masat për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2018; Takim i Komitetit Rajonal të Turizmit-Evidentimi i masave të marra nga të gjithë institucionet për

përballimin me sukses të sezonit turistik 2018, kryesisht me garantimin e furnizimit me energji elektrike, me ujë të pijshëm, shërbim shëndetsore, disiplinimin e ndotjes akustike etj. në zonat turistike bregdetare ashtu edhe ato malore. Miratimi i plan veprimit dhe grupit të punës për monitorimin e zbatimit të këtij plani, si dhe mbi potencialin e zhvillimit të turizmit (Takim datë 20 Janar, Takim datë 11 Maj; Takim datë 19 Qershor me një delegacion gjerman; Takim datë 29 Qershor mbi narjen e detyrave dhe inspektimin në terren të zbatimit të detyrimeve ligjore në sektorin e turizmit, si dhe takimet periodike javore të grupit të monitorimit të zbatimit të plan veprimit)

- Mbi zhvillimin e agroturizmit në qark, si dhe aplikimin dhe përfitim të subvencioneve, në mbështetje të fermerëve në vështirësi (Takim datë 13 Shtator)

- Mbi problemet në sektorin e ujit, në kuadrin e reformës së qeverisë në këtë sektor, goditjen e informalitetit dhe sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe përfundimin e riorganizimit të Sh.A ujësjellësit (Takim datë 25 Janar; Takime mujore periodike me përfaqësues të Sh.A dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë edhe takimet e grupit të punës)

- Mbi trajnimin e mësuesve dhe nxënësve kundër bulizmit në shkollë (Takim datë 08 Janar i iniciuar nga Kryeministri)

- Takim, edhe në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Bazenit Ujor “Drin-Bunë”, në kuader të zbatimit të Urdhërit Nr.228 datë 01.12.2017 të Kryeministrit “Për Ngritjen e Grupit Qendror Ndërinstitucional të Punës dhe Grupeve Vendore të Punës për Nderhyrjen ndaj Shfrytëzimit dhe Gërryerjeve të Brigjeve të Shtretërve të Lumenjve” (takim datë 11 Janar)

- Mbledhje e Këshillit të Bazenit Ujëmbjdhës Drin-Bunë, si dhe miratimi i Vendimeve përkatëse (takim datë 24 Janar; 7 Mars; 13 Qershor; 14 Gusht)

- Mbi masat për ndalimin e gërryerjes së shtretërve të lumenjve, në zbatim të VKM, ku përgjegjësia kryesore është e ISHMPUT, si dhe zbatimin e moratoriumit në pyje, goditja e paligjshmërisë së prerjes së pyjeve (Takim datë 3 Tetor)

- Mbi shërbimin shëndetësor në qark, problemet e hasura (mungesa e mjekësve, amortizimi i Q.Sh., etj.) dhe masat për përmirësimin e nivelit të shërbimit (Takim 30 Janar,

- Mbi procedurat për regjistrimin e tokës bujqësore, plotësimi i AMTP dhe regjistrimi në ZRPP-së, problemet e ndarjes së tokës në fshatra (Takim datë 31 Janar, iniciuar nga Kryetari i bashkisë Shkoder), në përfundim të të cilit u miratua memorandum bashkëpunimi në mes ZVRPP-së dhe DAMT-së (Takim datë 6 Shkurt, mbi problemet e ndarjes së tokës në fshatin Naraç, Nj.A Hajmel të bashkisë Vau i Dejës; Takim datë 22 Shkurt për problemet e mosndarjes së tokës sipas ligjit, fshatit Boriç i Madh, Nj.A Fruemirë, bashkia Malësi e Madhe; Takim datë 5 Qershor, mbi problematikat e pronësisë në zonën e bregdetit Velipojë, në zbatim të përgjegjësive dhe detyrave të Taskë-Forcës kombëtare, për verifikim edhe një here të akteve të pronësisë për pjesën e bregdetit dhe rolin e KVTP-së në këtë verifikim)

- Mbi domosdoshmërinë e ndërregjjesimit të komuniteteve lokale, në reduktimin e rrezikut të katastrofave për të gjithë rajonin duke përfshirë edhe shqipërinë (Takim datë 22 Shkurt me delegacionin qeveritar Kosovar, duke i kërkuar qendrës AARHUS mbështetje për



rritjen e ndergjegjsimit të komuniteteve lokale)

- Mbi marrjen e masave për menaxhimin dhe përballimin e situatave të emergjencave civile në qarkun Shkoder (Takim datë 26 Shkurt; takim datë 6 Mars; Takim i KECQ datë 8 Mars; Takim 25 Shtator, lidhur me masat për sezonin e dimrit;

- Në kuder të implementimit të projektit “*Katastrofat nuk njohin kufij*” në bashkëpunim me shtetin Mali Zi (Përfshirë takimit e grupit, takime ndermjet partnerëve dhe ndërinstytucionale, janë zhvilluar 21 takime)

- Analiza të veprimtarisë periodike e vjetore të Institucionit dhe Institucioneve rajonale

- Mbi problematikat e hasura gjatë zbatimit të skemës së re të përfshirjes dhe trajtimit me ndihmë ekonomike. Trajtimi i familjeve aplikuese që dalin nga skema (financim i bankës botërore), sipas sistemit, mund të ndihmohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet fondit 6 % (takim datë 15 Shkurt;

- Mbi realizimin e detyrave dhe disiplinën në punë të punonjësve të Institucionit dhe të Institucioneve Rajonale (Takim 6 Prill;

- Mbi masat për fillimin e vitit të ri arsimor dhe zhvillimin e procesit mësimor, sigurimin e ngrohjes në shkolla; takime lidhur me mbikëqyrjen dhe monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të provimeve të maturës shtetërore në mjediset e provimit (4 Takime me institucionet arsimore dhe grupin e punës i ngarkuar me monitorimin e procesit të provimeve Takim datë 29 Gusht; Takim datë 14 Nëntor)

- Mbi kërkesat dhe ankesat e shtetasve të ndryshëm, institucioneve dhe njësite të vetëqeverisjes vendore, të adresuara Institucionit, apo të ardhura nga Institucionet Qendrore (Takime, sipas rasteve dhe periudhave përkatëse)

#### **VIII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve**

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë viti në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje 103 kërkesa dhe ankesa të qytetarëve (kërkesa dhe ankesa të ardhura direkt, ose nepermjet institucioneve të tjera qendrore), të cilat sipas problematikës paraqiten:

- Për çështjet e pronësisë dhe zënien e hapësirave publike 20
- Për mjedisin e menaxhimin e mbetjeve 6
- Për çështjet e punësimit 17
- Për çështjet e strehimit 1
- Për dëmshpërblim dhe emergjencat 8
- Për shërbimin e furnizimit me energji elektrike (OSHEE) 2
- Për pagesën e Ndihmës ekonomike, Paaftësisë dhe invaliditetit 4

- Për masa administrative (falje gjoba) 13
- Të tjera 32

#### **VIII.5. Veprimtaria e N/Prefektit**

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e qarkut*”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka ushtruar detyrat funksionale, përcaktuar në detyrat e administratës së Prefektit (miratuar me Urdhrin Nr. 50, datë 12.04.2017, të Kryeministrit) dhe në Rregulloren Organizative të Brendshme të Institucionit, Kështu;

Ka bashkëpunuar me institucionet qendrore në nivel vendor, duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre,;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të ketyre institucioneve me bashkitë janë organizuar takime gjatë vitit për problemet e rendit, të turizmit, emergjencave;

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre;

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punjonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe NjA pjesë perbërëse e bashkive, si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve;

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

#### **IX. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT**

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për Kundravajtjet Administrative*”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “*Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor*”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria vendore e policisë në 115 raste, duke marrë vendimet përkatëse

## X. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku (*Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit*)

2. Përballimi i situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, apo nga faktor të tjerë (*Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente*)

3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale, si dhe fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën; Godja dhe shkatërrimi i kultivimit të kanabisit, duke e nxjerrë përfundimisht qarkun Shkodër nga harta e kultivimit; Sigurimi i rendit publik (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese*)

4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve, nepermjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (*Bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim*)

5. Goditja e informalitetit dhe zgjidhja e qëndrueshme në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm (*Bashkërendimi i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshi shoqëritë aksionere të UK*)

6. Krijimi i një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut, në kuadrin e nismës së ndërmarrë nga qeveria “*Të pastrojmë Shqipërinë që duam*” (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile, shoqata mjedisore, etj.*)

7. Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga ana e Drejtorisë Rajonale të OShEE Sh.A; Përmirësimi i treguesve ekonomiko-financiar dhe performancës; Ulja e nivelit të humbjeve në kufijtë e pranueshëm (*Bashkëpunimi, koordinimi i veprimtarisë së institucioneve rajonale, njësitë e vetëqeverisjes vendore me Degën Rajonale të OSHEE Shkodër, si dhe monitorimi i veprimtarisë*)

**P R E F E K T I**  
**Çesk MILLJA**